# USHTRIA

Viti i 68-të i botimit Nr. 19 (8220) | Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes | E premte, 16 maj 2014


CEREMONIA PËRKUJTIMORE



## Përkujtohet rënia e dëshmorëve të kombit, Konushevci dhe Malaj

*16-vjetori i rënies së dëshmorëve të kombit, Konushevcit dhe Malaj*

faqe 4

DIPLOMACIA USHTARAKE

**Prezantohet atasheu ushtarak i Republikës së Shqipërisë në Mal të Zi**

faqe 5

BASHKËPUNIMI

**FSK merr trajnime për sistemet e kodifikimit dhe logjistikën**

faqe 5

FORCË TOKËSORE



## Kursi komando një sfidë, ku jo gjithkush certifikohet

*Përfundoi kursi i 9-të komando i "Batalionit Komando"*

faqe 6

I PRANISHËM EDHE AMBASADORI I SHBA-SË, Z. ARVIZU

## Përurohet në Korçë memoriali për amerikanët e rënë në LIIB

*Gjeneralmajor Jeronim Bazo merr pjesë në ceremoninë e përurimit të memorialit të amerikanëve, në Korçë*



Faqe 4

### Drejtuesit më të lartë të FA vizitojnë trupat shqiptare në Afganistan

# Afganistani vizitohet nga e para ministre e Mbrojtjes...

*Ministrja Kodheli: Trupat në Afganistan, nderojnë gjithë shqiptarët kudo që janë SHSHP, gjeneralmajor Bazo vlerëson ushtarakët në mision dhe jep edhe një mesazh për ta*



Faqe 2-3

SIGURIA EUROPIANE

## Ukraina në prag të zgjedhjeve të 25 majit



*Vëmendja e Rusisë, Shteteve të Bashkuara, Evropës dhe NATO-s është drejtuar në Ukrainë. Edhe pse aftësia për të rivendosur autoritetin legjitim është në duart e qeverisë së Kievit, Kievi duket i vendosur për të përdorur forcën e armëve, ndërkohë legjitimiteti nuk mund të vendoset nga gryka e pushkëve.*

faqe 8-9

NATO

**Rasmussen: Angazhimi i NATO-s ndaj mbrojtjes kolektive, i fortë si shkëmb**

faqe 7

DËSHMORËT E AVIACIONIT

**Dy pilotë "Dëshmorë të Atdheut", shpallen "Qytetar Nderi" të Vlorës**

faqe 11

KULTURË

**"Dita Ndërkombëtare e Mjedisit", festohet Dita e Luleve**

faqe 15

TEKNOLOGJIA USHTARAKE



## Apokalipsi "drone"...

Termi "drone" vjen nga anglishtja, ku "drone", quhet mashkulli i bletës. Është përdorur ky emër për dronët elektrikë, për shkak të zhurmës tipike si të atyre natyral.

faqe 12-13

## Drejtuesit më të lartë të FA vizitojnë paqeruajtësit në Afganistan

# Afganistani vizitohet nga e para ministre e Mbrojtjes...

*Ministrja gjermane e Mbrojtjes, Ursula Von der Leyen, vetëm pak ditë pas marrjes së detyrës së saj si ministre, kreu një vizitë në kampin Marmal, Mazar-I-Sharif, në Afganistan, ku ndodhet shtabi i komandës veriore, nën kontrollin e trupave gjermane. Ajo fluturoi drejt Afganistanit në 22 dhjetor 2013, për të uruar trupat gjermane për Krishtlindje. Para 43 gazetarëve që e shoqëronin ajo foli mbi shumë çështje pasi edhe kjo vizitë shërbente për një fushatë të gjerë informimi në lidhje me politikat gjermane të Sigurisë, por ishte një fjali ndër të tjera, të cilën ajo e përmendi shpesh, në disa intervista: "Individi është gjëja më e rëndësishme, jo kostoja". Ajo e përsëriti vazhdimisht këtë gjë duke pranuar se shteti gjerman duhet të bënte edhe më shumë për familjet, gratë dhe fëmijët e ushtarakëve gjermanë në misione. E solla këtë fjali të thënë në vizitën e parë në Afganistan, të së parës ministre Mbrojtjes gjermane, pasi ka një paralelizëm qëndrimi me vizitën e parë në Afganistan, të së parës ministre Mbrojtjeje shqiptare, Mimi Kodheli. Në të dy rastet, edhe pse e thënë me formulime të ndryshme, premtimi ishte një: misionet e ushtarakëve janë të paçmueshme.*



Paqeruajtësit shqiptarë që shërbejnë në kuadër të ISAF, Afganistan, janë inspektuar së fundmi nga ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Jeronim Bazo. Qëllimi i vizitës ishte njohja e situatës dhe gjendjes së trupave të Forcave të Armatosura të dislokuara në mision, si dhe takimi me drejtuesit më të lartë të operacionit ISAF. Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Jeronim Bazo zhvilluan një vizitë 24 orëshe në Afganistan. Drejtuesit e Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm të FA u takuan me komandantin e misionit ISAF, gjeneral Joseph F. Dunford, me ambasadorin e NATO në Afganistan, Maurits R. Jochems, me komandantin e Komandës së Bashkuar gjenerallejtënant Joseph Anderson, si dhe me gjeneral brigade, James E. Rainey, zëvendëskomandantin e Komandës Rajonale të Jugut, komanda direkte nën të cilën veprojnë trupat speciale shqiptare, të cilat kontribuojnë për paqen në Afganistan, në rajonin e Kandaharit. Në takimet e tyre me drejtues civilë dhe ushtarakë, ministrja Kodheli dhe gjeneralmajor Bazo, diskutuan për problematikën e tranzicionit të misionit ISAF pas vitit 2014, për aspektet operacionale aktuale, për kontributin që japin Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë në këtë operacion dhe perspektivën e kontributit të FA në periudhën post-ISAF. Në këtë kuadër znj. Kodheli edhe një herë rikonfirmoi angazhimin e qeverisë shqiptare për të mbështetur vendimin e Aleancës. Vizita e ministres së Mbrojtjes dhe shefit të Shtabit të FA në Afganistan, shërbeu për të kontaktuar në mënyrë të drejtpërdrejte me trupat tanë në terren.

Delegacioni i lartë i FARSH gjatë takimeve me personelin që shërben në shtabin e ISAF, ekipin "MAT 5" dhe "Eagle 8", u informua mbi përgjegjësitë dhe detyrat që kryejnë ata në terren. Ministrja e Mbrojtjes dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA shprehën gatishmërinë për mbështetjen e gjithanshme, duke konsideruar proceset që çojnë në përmirësimin e kushteve të punës, jetesës dhe trajtimit të personelit të FARSH dhe veçanërisht të atyre që shërbejnë me misione jashtë vendit. Ministrja Kodheli dhe Gjeneral Bazo shprehën vlerësimin maksimal për profesionalizmin e treguar nga personeli paqeruajtës për realizimin me sukses të detyrave të ngarkuara.

Nëpërmjet një bashkëbisedimi të ngrohtë, ministrja e Mbrojtjes tregoi mbështetjen maksimale dhe të pakursyer, të qeverisë, Ministrisë së Mbrojtjes, për detyrën e vështirë dhe të rëndësishme që ata po kryejnë. Në kuadër të takimit me trupat tona, znj. Kodheli, i informoi për programet që qeveria, administrata e re shqiptare ka në drejtim të FA, mbështetjes së tyre në konsolidimin e proceseve që çojnë në përmirësimin e kushteve të ushtarakut, në trajtimin e tyre të ndershëm në raport me kërkesat e detyrave. Znj. Kodheli i informoi ushtarakët tanë për reformimin, që po i bëhet Forcave të Armatosura, për punën në drejtim te përmirësimit të kuadrit ligjor, që synon rikthimin e dinjitetit të ushtrisë në përputhje me standardet e NATO-s. Znj. Kodheli dhe gjeneralmajor Bazo në takimet direkt me efektivët e MAT 5 dhe Eagle 8, dy misione të cilat shërbejnë në Kabul dhe Kandahar përkrah aleatëve tanë, vlerësuan profesionalizmin e tyre në kryerjen e detyrës. Ministrja Kodheli falënderoi trupat tanë për përkushtimin me të cilin po bëjnë detyrën e tyre tejet të vështirë por shumë të rëndësishme. Angazhimi i tyre me përgjegjshmëri maksimale në kryerjen e detyrave është mbresëlënës, theksoi znj. Kodheli. "Në takimet që unë pata me drejtues të lartë ushtarakë dhe civilë, vura re me kënaqësi se komandantët e Aleancës në terren, ndajnë të njëjtin vlerësim: 'trupat speciale shqiptare janë të përgjegjshme dhe në lartësinë e detyrës së tyre' dhe kjo më gëzoi dhe me mbushi me krenari", - nënvizoi kreu i Mbrojtjes.

Gjatë takimeve me gjeneralët e sipërpërmendur, drejtuesit e lartë shqiptarë të MM dhe SHPFA, teksa diskutuan për perspektivën e kontributit të FARSH në këtë vend, rikonfirmuan plotësisht edhe njëherë qëndrimin e qeverisë dhe politikës shqiptare, për vazhdimin e angazhimit të FARSH në mbështetje të vendimeve të Aleancës mbi të ardhmen e prezencës e rolit në Afganistan. Padyshim që paraqitja e trupave shqiptare dhe qëndrimi shumë pozitiv shtetëror shqiptar, është tregues i një konsolidimi pozite brenda Aleancës.

## Vlerësime të gjithanshme për trupat shqiptare

Në datat 10 dhe 11 maj 2014 ministria e Mbrojtjes Znj. Mimi Kodheli dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Jeronim Bazo zhvilluan një vizitë në Afganistan me qëllim inspektimin e trupave shqiptare që shërbejnë në kuadër të misionit ISAF. Pjesë e delegacionit ishin gjithashtu kolonel Idriz Haxhiaj, drejtor i J-3/7 në Shtabin e Përgjithshëm dhe n/kolonel Qazim Hoxha, komandant i Batalionit të Forcave Speciale. Përveç takimeve të zhvilluara me komandantin e ISAF gjeneral Josef F. Dunford, ambasadorin e NATO-s pranë shtabit të ISAF-it, Mauritus R. Jochems dhe komandantin e Komandës së Bashkuar të ISAF (IJC), Gjenerallejtënant Joseph Anderson, ministria e Mbrojtjes dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA u takuan edhe me ekipin këshillimor MAT-5, përfaqësues të FA që punojnë në shtabin e IJC dhe Komandën Rajonale të Perëndimit (RC-W). Takimi me ushtarakët shqiptarë nisi me fjalën e mirëseardhjes, mbajtur nga n/kolonel Etor Shehu, përfaqësuesi ushtarak më i lartë në ISAF. Kolonel Ardian Bali, Komandant i ekipit MAT-5, informoi ministren e Mbrojtjes mbi misionin, detyrat dhe përbërjen e ekipit. Gjithashtu kolonel Bali bëri një ekspoze të punës tashmë 2-mujore të



këtij ekipi si dhe rezultatet e arritura në këshillimin e shtabit të Brigadës së parë të Reagimit të Shpejtë, e dislokuar në Kabul. Në fjalën e tij, komandanti i MAT-5 theksoi bashkëpunimin e shkëlqyer që ekziston ndërmjet ushtarakëve shqiptarë dhe atyre amerikanë, pjesë e këtij ekipi, si dhe siguroi Ministren e Mbrojtjes dhe Shefin e Shtabit të Përgjithshëm se ky ekip do të punojë me përkushtim e profesionalizëm për plotësimin e misionit dhe që flamuri ynë kombëtar të valëvitet krenar përkrah 27 flamujve të tjerë pjesë e Aleancës. Në takim merrnin pjesë edhe ushtarakë amerikanë, pjesë e ekipit MAT-5. N/kolonel Erik Myhre, oficer ekzekutiv i MAT-5, nënvizoi profesionalizmin e ushtarakëve shqiptarë dhe frymën e grupit ku rëndësi të veçantë i kushtoi lidershipit të këtij kontingjenti për krijimin e kësaj klime bashkëpunimi dhe miqësie. Në fjalën e saj znj. Kodheli shprehu mirënjohjen për këtë detyrë të vështirë dhe njëkohësisht fisnike që ushtarakët tanë bëjnë në Afganistan. Ajo i siguroi ata se do të jetë pranë problemeve dhe shqetësimeve të çdo ushtaraku sidomos atyre që ndodhen me mision, kontributi i të cilëve bën krenar jo vetëm FA dhe familjet e tyre por çdo shqiptar. Gjeneral Bazo u shpreh i surprizuar nga fjalët e n/kolonel Myhre dhe theksoi faktin se ndjehej krenar që ushtarakët shqiptarë kryejnë me profesionalizëm të lartë detyrat që u ngarkohen. Më pas takimi kaloi në një atmosferë të ngrohtë bashkëbisedimi ku nuk munguan dhe shakatë me ushtarakët amerikanë, pjesë e ekipit MAT-5. Takimi në bazën NKAIA përfundoi me një foto të përbashkët dhe më pas delegacioni i shoqëruar nga n/kolonel Etor Shehu dhe Kapiten Olger Iljazi fluturuan drejt Kandaharit ku do të takoheshin me personelin e kontingjentit Eagle-8. Në bazën ajrore të Kandaharit delegacioni u prit nga zv/komandanti i Komandës Rajonale të Jugut (RC-S) dhe komandanti i kontingjentit Eagle-8, major Agron Kuta. Pas përfundimit të takimit me zv/komandantin e RC-S delegacioni u drejtua për në vendin ku do të zhvillohej takimi me personelin e kontingjentit Eagle-8. Fillimisht major Kuta e njohu ministren e Mbrojtjes dhe Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA me misionin dhe detyrat që forcat tona speciale kryejnë në rajonin e Spin Boldakut. Në fjalën e saj ministria Kodheli i falënderoi forcat tona speciale për përmbushjen me sukses të këtyre detyrave, shpesh herë duke vënë në rrezik edhe jetën. Takimi në Kandahar përfundoi dhe delegacioni u nis përsëri në drejtim të Kabulit ku i gjithë delegacioni dhe pjesëtarë të FA në shtabin e ISAF-it qëndruan së bashku dhe biseduan në një atmosferë shumë të ngrohtë deri në mbrëmje vonë. Të nesërmen ministria e Mbrojtjes dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA vendosën një kurorë me lule në memorialin e të rënëve në operacionin ISAF. Më pas delegacioni i kryesuar nga ministria Kodheli u nis në drejtim të Aeroportit Ndërkombëtar të Kabulit ku dielli i ngrohtë i asaj dite ishte simboli më i mirë i ngrohtësisë dhe përkujdesjes që Ministri i Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i FA kanë për ushtarakët tanë që shërbejnë me mision në Afganistan.

***Informacioni mbi detajet e vizitës u sigurua nga kontakti me kol. Ardian Bali, komandanti i ALB-USA MAT 5***

**STAFI**

**Kryeredaktor:** Albert **HITOALIAJ**

**Gazetarë:** Mimoza **GOLIKJA**, Alba **MUSARAJ**

**Redaktore korrektore:** Elona **SHIMAJ MAKO**

**Graphic Designer:** Afërdita **HYSAJ**

ADRESA: **Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës**

INTERVISTAT

# Mesazhi, mbështetje pa kursim për trupat shqiptare

*Në përfundim të vizitës së tyre, krerët e lartë shqiptarë të Mbrojtjes, dhanë nga një intervistë për mediat. Këto intervista në të cilat u shprehën vlerësimet e marra për trupat shqiptare dhe ku u dhanë edhe mesazhet e drejtuesve për ato trupa, po i sjellim të plota si më poshtë.*

## Ministrja Kodheli: Trupat në Afganistan, nderojnë gjithë shqiptarët kudo që janë



**Zonja ministre, kjo është vizita juaj e parë te trupat në Afganistan. Si i gjetët djemtë tanë atje?**

I gjeta mirë, me humor të lartë e në gatishmëri të lartë, krenarë për detyrën që bëjnë dhe mirë me shëndet. Jam krenare për atë çka pashë dhe shpresoj shumë që edhe ata të kenë mbetur të kënaqur nga kjo vizitë.

**Ju patët edhe një sërë takimesh me krerët e lartë të ISAF-it. Cilat ishin disa prej tyre dhe mesazhet që morët?**

Më së pari me gjeneralin me katër yje, komandantin e ISAF-it, gjeneral të cilin unë kam pasur fatin ta takoj edhe në disa ministeriale. Është shumë i rëndësishëm mesazhi që ai përcolli te unë. Ata janë shumë të kënaqur me Forcat tona Speciale, me të gjithë atë trupë, pjesë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët janë këtu prezent, bashkëpunojnë me ta e përpiqen që të plotësojnë të gjitha detyrimet që NATO ka në këtë mision sa të vështirë aq edhe fisnik, siç është misioni ISAF.

**Cili është mesazhi që ju dhatë për forcat këtu në Afganistan, në fund të vizitës tuaj?**

Ajo çka bëjnë ata, këtu në Afganistan, është jo vetëm në nderin e Forcave të Armatosura, por në nderin e gjithë shqiptarëve kudo që janë, ndaj këtë mesazh jam munduar që t'ua përçoj, MAT-5, Eagle-8, për t'i dhënë atyre jo vetëm këtë mesazh, por për t'i dhënë një mesazh Shqipërisë dhe shqiptarëve kudo që janë. Forcat e Armatosura në detyrimin e tyre kushtetues dhe ligjor dhe në respekt të së qenit pjesë e një armate të tërë që quhet NATO, janë nderi i Shqipërisë, janë nderi i këtij organizmi sa politik edhe ushtarak, që ekziston dhe ka një mision të vetëm: demokracinë kudo dhe për këdo. Ndaj, një mesazh tjetër që do t'i jap politikës shqiptare që nga Kabuli i largët është: lërini Forcat e Armatosura jashtë diskutimeve politike; le të mundohemi që këto Forca të mund t'i mbështesim për të rritur profesionalizmin e tyre dhe të mund të jemi, siç dhe jemi këtu, pjesë e denjë e kësaj Aleance - të cilën e them dhe e konsideroj sa politike aq dhe ushtarake – në respekt të detyrimit kombëtar dhe ndërkombëtar që këto forca kanë, sjelljen e paqes, qoftë edhe në një vend të vështirë siç është Afganistani.

Mendoni të vini sërish t'i shihni, keni ndonjë plan tjetër?

NATO është në një proces i cili do të ketë në përbërje të tij brenda këtij viti, dy momente të rëndësishme: Ministerialin e fillim-qershorit dhe më apo Samitin e Wells-it. Do të merren këtu vendime të rëndësishme që do të kenë të bëjnë me të ardhmen e misionit të Afganistanit, me të ardhmen e ISAF, me të ardhmen e Forcave të Armatosura prezent në Afganistan, por edhe me probleme të rëndësishme, madje shumë të rëndësishme gjeopolitike, siç është e ardhmja e Ukrainës, siç janë problemet në Siri, apo kudo ku demokracia është e brishtë, kudo ku në botë sundon një sistem i cili nuk është demokratik apo ku ka luftëra të natyrave të ndryshme. Besoj se bazuar në vendimet politike që NATO do të marrë në këtë rast ne do të mundësojmë edhe vendimmarrjen tonë me të ardhmen e trupave tona këtu, por edhe me atë çka Aleanca dhe aleatët do të bëjnë me demokracinë në botë.

# "Ka ndryshim cilësor në shërbimin e trupave tona në Afganistan"

## SHSHP, gjeneralmajor Bazo vlerëson ushtarakët në mision dhe jep edhe një mesazh për ta






**Zoti gjeneral, është vizita juaj e disatë që ju bëni te trupat tanë në Afganistan. Si i gjetët djemtë tanë këtë radhë?**

Është e vërtetë që kjo është vizita ime e dytë ose e tretë dhe interesante është të vësh re faktin se ka një ndryshim cilësor në shërbimin e trupave tona në Afganistan. Nga vizitat e mia të mëparshme, vë re që ne kemi rritur shërbimin cilësor për sa i takon zinxhirit të komandimit në trupat e ISAF-it. Në vizitën time të mëparshme ne nuk shërbenim në ekipin këshillimor të Ushtrisë afgane, ndërsa sot siç e ndoqëm së bashku ne këshillojmë shtabin e një brigade afgane, pra kryejmë thelbin cilësor të rritjes, të funksionimit sa më mirë të forcave të sigurisë afgane, të cilat me kalimin e kohës do të marrin në dorë sigurinë e këtij vendi. Pra, vura re me krenari që komandanti, gjeneral Joseph F. Dunford dhe i gjithë zinxhiri i komandimit në ISAF thanë fjalët më të mira për trupat tona dhe kjo na bën të ndjehemi vërtet mirë, krenarë për shërbimin që ofrojmë në këtë operacion.

**Keni ndonjë mesazh përfundimtar pas kësaj vizite?**

Qëllimi i vizitës sonë në Afganistan ishte për të mbajtur premtimin e kahershëm që përveç merakut të përditshëm që kemi, komunikimit të përditshëm që kemi, mbështetjes së përditshme që u japim trupave tona, është tepër e rëndësishme që t'i takojmë ata edhe fizikisht. Është shumë më ndryshe takimi sy më sy, ku tregon mbështetjen, tregon përkrahjen dhe tregon se sa realisht krenarë jemi për shërbimin e tyre këtu në Afganistan. Njëkohësisht u thamë që të ndjehen të qetë në punën e tyre të përditshme, në shërbimin e tyre me sakrifica, sepse kanë gjithmonë mbështetjen e SHPFA, MM dhe janë gjithmonë në qendër të vëmendjen sonë dhe të jenë krenarë për atë që bëjnë. Profesioni që kanë zgjedhur është një profesion nga më të vështirët, por është një profesion që vihet në shërbim dhe që në radhë të parë Atdheun, pavarësisht se sa mijëra kilometra larg tij shërbehet…

# Përurohet në Korçë memoriali për amerikanët e rënë në LIIB

Në datën 8 maj 2014, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Jeronim Bazo, mori pjesë në ceremoninë e përurimit të memorialit të amerikanëve, anëtarë të Zyrës së Shërbimeve Strategjike gjatë Luftës së Dytë Botërore në qytetin e Korçës. Në ceremoni ishin të pranishëm dhe ambasadori i SHBA, Aleksandër Arvizu, nënkryetarja e Bashkisë së Korçës, Themeli, përfaqësues nga Ambasada amerikane, etj. Ceremonia është hapur nga ish-presidenti Alfred Moisiu, i cili ka vlerësuar kontributin amerikan gjatë Luftës së Dytë Botërore. Më tej ceremoninë e përurimit të memorialit të amerikanëve e ka përshëndetur shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Jeronim Bazo. Gjeneral Bazo ndër të tjera u shpreh se: "SHBA kanë qenë përkrah Shqipërisë dhe shqiptarëve jo vetëm kur ekzistenca e tyre ka qenë e kërcënuar por gjatë gjithë historisë së shtetit shqiptar, ka ofruar ndihmën, mbështetjen dhe bashkëpunimin e saj, kjo e shprehur në mënyra dhe e drejtuar në fusha të ndryshme. Njëra prej tyre ishte edhe mbështetja e përpjekjeve për të luftuar pushtuesit gjermanë gjatë Luftës së Dytë Botërore." Më tej ceremonia është përshëndetur edhe nga përfaqësues të Ambasadës amerikane dhe përfaqësues nga Bashkia e Korçës.



Gjeneralmajor Jeronim Bazo merr pjesë në ceremoninë e përurimit të memorialit të amerikanëve, në Korçë; i pranishëm edhe ambasadori i SHBA-së, z. Arvizu



# QS zhvillon stërvitjen simuluese me KTHOSH, "Rozafa '14"

Që prej disa ditësh në mjediset e QS me Kursin Themelor të Oficerit të Shtabit të AFA, po zhvillohet stërvitja "Rozafa-14". Qëllimi i Stërvitjes është që të planifikohet dhe të ekzekutohet një stërvitje për vendimmarrje në vend-komandë (CPX/CAX) që të jetë e thjeshtë dhe efektive në nivelin taktik dhe të adresojë në të njëjtën kohë nevojat për trajnimin dhe zhvillimin e dy audiencave stërvitore të rëndësishme. Objektivat e kësaj stërvitjeje janë sigurimi i një stërvitje të cilësisë së lartë për oficerët student që ndjekin Kursit Themelor të Oficerit të Shtabit, i cili përdor mësim eksperimental dhe i mundëson studentëve të shohin rezultatet/pasojat e planifikimit dhe vendimmarrjes së tyre, sikundër dhe ndërtimi i bazës së njohurive kolektive që kanë lidhje me efikasitetin/menaxhimin trajnues të trupës pedagogjike. Shefi i QS, kolonel Dritan Demiraj u shpreh për këtë stërvitje se: "Në drejtim të masave të marra për realizimin e kësaj stërvitjeje kemi përshtatur programin sipas nevojës për të garantuar përdorimin më të mirë të kohës dhe burimeve të disponueshme për mbështetje. Aplikimi i procedurave të provuara më parë për projektimin, ekzekutimin dhe vlerësimin e stërvitjes, do të rrisin vlerat trajnuese/zhvilluese të kësaj stërvitjeje jo vetëm për drejtuesit dhe pjesëtarët e stafit të Qendrës së Simulimit, por dhe për audiencën stërvitore të KTHOSH". Shefi i Departamentit të Operacioneve në AFA, kolonel David Rroku për këtë stërvitje është shprehur se: "Qendra e Simulimit dhe Akademia e Forcave të Armatosura po punojnë së bashku për të siguruar një mjedis mësimi real që kursantët të përmirësojnë njohuritë e tyre, eksperiencën dhe besimin në detyrat themelore të misionit. Me këtë stërvitje ne kemi hyrë në një epokë të re të sofistikimit dhe aftësive trajnuese. Si rrjedhojë, ne duhet të shohim në mënyrë të vazhdueshme se si t'i bëjmë gjërat më mirë, më me zgjuarsi dhe me më pak kosto. Ne duhet të kërkojmë ato situata ku sistemet, proceset dhe doktrinat e vjetra nuk i shërbejnë më interesit tonë më të mirë dhe pastaj të jemi të gatshëm të zhvillojmë dhe të prezantojmë zgjidhje të reja. Përdorimi dhe funksionimi në parametrat e duhura të Qendrës së Simulimit shërben si katalizator për këtë lloj inovacioni dhe mënyre të menduari dhe ne duhet të përfitojmë maksimalisht nga kjo gjë". Zëvendëskomandanti i KDS, kolonel Ruzhdi Kuçi, ndoqi nga afër zhvillimin e një prej ditëve të fazës stërvitore të stërvitjes "Rozafa 14" me kursantët e KTHOSH në QS.

# Farkë, italianët ofrojnë ndihmë për mirëmbajtjen e helikopterëve

Nga data 5 maj deri në datën 9 maj 2014, në kuadër të planit të bashkëpunimit dypalësh midis Forcës Ajrore, shqiptare dhe asaj italiane për vitin 2014, në Bazën Ajrore Farkë u zhvillua aktiviteti me një ekip italian ekspertësh pilotë dhe teknikë për inspektimin dhe dhënien e konsulencës së tyre për mirëmbajtjen e helikopterëve AB-205 dhe AB-206. Ekipi italian i ekspertëve përbëhej nga kapiten Alessandro Faroppa, pilot/kolaudator helikopterësh dhe kapiten Marco Giorgetti, specialist mirëmbajtje helikopterësh, ndërsa pjesëmarrës nga pala shqiptare ishin oficerë të mirëmbajtjes së teknikës ajrore nga



Shtabi i Forcës Ajrore dhe Baza Ajrore Farkë. Ditën e parë të aktivitetit ekipi italian i ekspertëve u prit në takim nga drejtues të Bazës Ajrore Farkë, të cilët pasi i falënderuan për zhvillimin e këtij aktiviteti të rëndësishëm, bënë edhe një pasqyrë të gjendjes së helikopterëve AB-205 dhe AB-206, kapacitet operacionale që përmbush kjo lloj teknike, si dhe nevojat në të ardhmen për mirëmbajtjen e tyre. Aktiviteti u zhvillua gjatë ditëve në vazhdim me inspektimin e teknikës ajrore dhe dokumentacioneve respektive të mirëmbajtjes, duke shkëmbyer eksperiencën e tyre në fushën e mirëmbajtjes. Pjesë e aktivitetit ishte edhe vizita e zhvilluar në ambientet e Bazës Ajrore Kuçovë, ku ekipi italian u njoh dhe inspektoi nga afër helikopterët AB-206, gjendjen aktuale të tyre, si dhe infrastrukturën që ofron kjo bazë. Aktiviteti u vlerësua i suksesshëm nga të dyja palët, ku u diskutua dhe u ra dakord në parim për mbështetjen nga ana e ushtrisë italiane për mirëmbajtjen e helikopterëve AB-205 dhe AB-206, me qëllim rikthimin në operacionalitet të kësaj teknike. Ekipi italian i ekspertëve shprehu gatishmërinë e dhënies së asistencës së tyre në fushën e mirëmbajtjes së teknikës ajrore, duke vlerësuar edhe profesionalizmin dhe nivelin e lartë teoriko-teknik të personelit të mirëmbajtjes në Forcën Ajrore.

## Përkujtohet rënia e dëshmorëve të kombit, Konushevci dhe Malaj

Në auditorin e Ministrisë së Mbrojtjes, u zhvillua paraditen e datës 9 maj 2014, ceremonia përkujtimore e 16-vjetorit të rënies së dëshmorëve të kombit, gjeneral Ilir Konushevcit dhe bashkëveprimtarit të tij, dr. Hazir Malaj. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast ishin të pranishëm zëvendëskomandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralmajor Rrahman Rama, zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Muhamet Latifi, komandanti i Forcës Tokësore të FARSH, gjeneralmajor Zyber Dushku, përfaqësues të ambasadës së Kosovës, familjarë, miq dhe kolegë të dëshmorëve, etj. Ceremonia u hap me ekzekutimin e Himnit të Flamurit dhe më pas u mbajt një minutë heshtje në nder të së rënëve. Historiani i Kosovës, z. Skënder Zhitia, mbajti një kumtesë në nder të jetës dhe veprës së dëshmorëve të kombit gjeneral Ilir Konushevci dhe dr. Hazir Malaj. Gjithashtu kjo ceremoni u përkujtua me nderim edhe nga zëvendëskomandanti i FSK gjeneralmajor Rrahman Rama dhe zëvendësministri i FSK-së, Muhamet Latifi. Në këtë përvjetor të gjashtëmbëdhjetë të rënies së dëshmorëve Konushevci dhe Malaj, u mbajt një kumtesë edhe nga komandanti i Forcës Tokësore të FARSH, gjeneralmajor Zyber Dushku, i cili vlerësoi maksimalisht kontributin e tyre në luftën për çlirimin e Kosovës, duke u bërë simbol i mishërimit të vlerave më sublime.

## Ekzaminohen metodat për bashkëpunim mes legjislativit dhe FA

Javën e shkuar, në ambientet e auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes u zhvillua seminari "Ndërtimi i urave të bashkëpunimit mes legjislativit dhe Forcave të Armatosura", i organizuar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në bashkëpunim me Zyrën e Bashkëpunimit Ushtarak (ODC). Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga Shtabi i Përgjithshëm i FA, Ministria e Mbrojtjes, komandat kryesore, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, si dhe përfaqësues të zyrës së ODC. Seminari "Ndërtimi i urave të bashkëpunimit mes legjislativit dhe Forcave të Armatosura", solli në fokus ekzaminimin metodave që mund të përdoren nga autoritetet civile dhe Forcat e Armatosura për ndërtimin e urave të bashkëpunimit dhe rritjen e efiçencës midis tyre.

# FSK merr trajnime për sistemet e kodifikimit dhe logjistikën

Në zbatim të detyrës së vënë nga shefi i Shtabit te Përgjithshëm të FA, më datë 14.05.2014, u zhvillua, vizita e një ekipi kosovar në Drejtorinë e Logjistikës. Takimi i zhvilluar në sallën e mbledhjeve të Shtabit të Përgjithshëm, me ekipin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, kishte qëllim njohjen me procedurat dhe etapat që duhen ndjekur për implementimin e një sistemi kodifikimi. Nëpërmjet prezantimit të Drejtorisë Logjistike ekipi u njoh me historikun e zhvillimit dhe implementimit të sistemit të Kodifikimit të NATO-s në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, bazën ligjore për ngritjen dhe funksionimin e Zyrës Kombëtare të Kodifikimit, strukturën, programet në përdorim për realizimin e këtij procesi, trajnimet e kryera nga ana jonë me personelin logjistik për procedurat e kodifikimit, mënyrën e evidentimit të aktiveve në inventarin e Forcave të Armatosura, STANAG-ët e ratifikuar në kuadrin e funksionimit sipas kërkesave të NATO-s dhe punën e bërë deri më tani. Në takim u diskutuan mënyrat dhe rrugët për implementimin e një sistemi kodifikimi në përputhje me kushtet dhe sasinë e aktiveve në inventarin e FSK. Më pas u demonstrua praktikisht mënyra e evidentimit të artikujve dhe përdorimi i programeve NMCRL (NATO Master Catalogue of References for Logistics) dhe BULCOD (Bulgarian Codification) të cilët nuk përmbajnë material të klasifikuar. Në përfundim të takimit ekipi i Forcës së Sigurisë së Kosovës shprehu mendimin për vazhdimësi të bashkëpunimit në të ardhmen si dhe pjesëmarrjen e personelit të tyre në trajnimet periodike që ne organizojmë për personelin logjistik çdo vit. Atasheu Ushtarak i Forcave të Armatosura të RSH për Kosovën ishte i pranishëm ne takim dhe do të jetë pika e kontaktit për koordinimin e mëtejshëm midis dy vendeve.

DIPLOMACIA USHTARAKE

# Prezantohet atasheu ushtarak i Republikës së Shqipërisë në Mal të Zi

Në datën 13 maj 2014, kolonel Fiqiri Hoxha - me detyrë Atashe Ushtarak i Republikës së Shqipërisë jo rezident në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Bosnje-Hercegovinë, zhvilloi një vizitë prezantuese në Ministrinë e Mbrojtjes të Malit të Zi. Në këtë takim kolonel Fiqiri Hoxha u prit nga sekretari i Shtetit në Ministrinë e Mbrojtjes Bojan Šarkić, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Malit të Zi, admiral Dragan Samardzic, zëvendësministri për politikat e mbrojtjes Ph.D Ivan Mašulović si dhe shefi i Departamentit të Zbulimit Ushtarak dhe Çështjeve të Sigurisë, Goran Poleksić. Atasheu Ushtarak i RSH, u shoqërua në këto takime nga Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Malit të Zi, SH.T Tonin Beci. Qëllimi i kësaj vizite, ishte prezantimi i Atasheut Ushtarak të Republikës së Shqipërisë, pranë autoriteteve të Ministrisë së Mbrojtjes në Republikën e Malit të Zi. Fillimisht Kolonel Fiqiri Hoxha u prit nga Sekretari i Shtetit në Ministrinë e Mbrojtjes, i cili vlerësoi shumë faktin që Shqipëria ka një atashe ushtarak në Mal të Zi. Z.Bojan Šarkić informoi mbi përparimin e Malit të Zi në fushën e proceseve evropiane dhe euroatlantike të integrimit, reformat e sektorit të mbrojtjes dhe planet për të ardhmen. Marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi në fushën e mbrojtjes, kanë qenë të mira, por me vendosjen e atasheut ushtarak të RSH, do të marrin një zhvillim të ri - u shpreh Z.Šarkić. Ne shpresojmë që në Samitin e Wellsit në Shtator, të marrim lajme të mira për sa i përket anëtarësimit në NATO dhe për këtë kërkojmë mbështetjen e Shqipërisë. Gjithashtu ai u shpreh se kërkojmë mbështetjen e Shqipërisë për sa i përket eksperiencës që ajo ka fituar në ngritjen e strukturave si ajo e Përfaqësisë së Përhershme në Bruksel etj. Kolonel Hoxha dhe ambasadori Beci shprehën mirënjohjen e tyre për pritjen e ngrohtë duke theksuar se Republika e Shqipërisë mbështet fuqishëm proceset integruese euro-atlantike të Malit të Zi dhe se ajo do të vazhdojë të jetë një partner i vendosur për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Malit të Zi, në të gjitha fushat e bashkëpunimit. Gjithashtu u theksua se Mali i Zi është në rrugën e duhur kur është fjala për proceset e integrimeve euro-atlantike dhe se Republika





e Shqipërisë është e gatshme të ndajë përvojën e saj dhe të japë mbështetje të pakushtëzuar për Malin e Zi në rrugën e saj në NATO. Më pas kolonel Hoxha u takua me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Malit të Zi, i cili e falënderoi për vizitën duke i uruar suksese në këtë detyrë dhe vlerësoi shumë bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes të RSH, Forcave të Armatosura dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Malit të Zi dhe Forcave të Armatosura të tij. Kolonel Hoxha dhe ambasadori Beci, gjatë takimit me admiral Dragan Samardzic, theksuan se Mali i Zi dhe Shqipëria kanë një bashkëpunim të mirë në fushën e mbrojtjes, dhe se Republika e Shqipërisë do të vazhdojë të jetë një partner i besueshëm për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Malit të Zi, në të gjitha fushat e bashkëpunimit. Takimi i radhës i Atasheut Ushtarak Kolonel Fiqiri Hoxha ishte me Zëvendës ministrin për politikat e mbrojtjes Ph.D Ivan Mašulović, i cili gjithashtu vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm dhe theksoi rritjen e këtij bashkëpunimi në të ardhmen. Takimi i fundit ishte me shefin e Departamentit të Zbulimit Ushtarak dhe Çështjeve të Sigurisë, Goran Poleksić, i cili theksoi se Agjencia e Inteligjencës që ai drejton është në fazën e ristrukturimit dhe duke patur parasysh së homologët shqiptar kanë një përvojë të mirë në këtë drejtim, kërkojmë mbështetjen tuaj. Në planin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Malit të Zi, është planifikuar një aktivitet për bashkëpunimin në fushën e zbulimit, kundërzbulimit dhe çështjet e sigurisë. Si dy vende fqinje, u shpreh zoti Poleksić, ne jemi të gatshëm të shkëmbejmë informacion në fushën e zbulimit, për problemet që cenojnë Forcat e Armatosura dhe sigurinë kombëtare.

# BCU, diskutohet problematika dhe analizohet puna

Drejtoria e Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak në SHPFA zhvilloi pak ditë më parë një seminar me personelin e strukturave të BCU-së të komandave dhe njësive të FA-së, me qëllim trajtimin e çështjeve kryesore të cilat u inspektuan gjatë kontrollit të ushtruar nga J9 në muajin prill 2014, si dhe problematikave të dala gjatë monitorimit të stërvitjes së b2k të Forcës Tokësore. Takimi u hap nga drejtoresha e Bashkëpunimit Civilo-Ushtarak në SHPFA, kolonele Manushaqe Shehu, e cila nënvizoi arritjet e deritanishme në punën dhe aktivitetin e përditshëm të kësaj strukture, por gjithashtu vuri në dukje dhe problemet e dala gjatë aktivitetit të përditshëm. Gjatë bashkëbisedimeve u trajtuan problematika të ndryshme të hasura nga personeli i BCU-së, të cilat janë konstatuar gjatë komunikimit të përditshëm me këto struktura dhe që ndikojnë drejtpërsëdrejti në realizimin me sukses ose mosrealizimin e detyrave që rrjedhin



nga misioni i BCU-së. Një analizë e veçantë iu kushtua përfundimeve të nxjerra nga monitorimi i drejtpërdrejtë i stërvitjes së b2k të Forcës Tokësore, ku gjatë kësaj stërvitje për emergjencat civile u vërejtën probleme gjatë procesit të planëzimit dhe se si konkretisht struktura e BCU-së realizonte në terren detyrat dhe misionin e saj në planin e përgjithshëm të operacionit. Pjesë e rëndësishme e seminarit ishte zbatimi me korrektësi i rregullave dhe normave të përcaktuara në udhëzimin e SHSHPFA "Mbi procedurat e punës për planëzimin dhe zbatimin e planeve të informimit publik në FARSH". Një pikë e veçantë e seminarit e cila u trajtua gjerësisht ishte ndërtimi i planeve të bashkëpunimit me autoritetet civile sipas rajoneve të dislokimit, ku strukturat e BCU-së duhet të përgatisin dhe të përfshijnë në dosjen e planëzimit vjetor planet e bashkëpunimit me autoritetet civile të përcaktuara sipas matricës kryesore të aktiviteteve të komandave dhe njësive. Në këtë seminar për të pranishmit u kërkua përgatitja e projekt planeve ku të përfshiheshin veprimtari të ndryshme si ditë të hapura për publikun me qëllim për t'i njohur ata rreth aktivitetit që komandat realizojnë në periudha të caktuara të vitit. Me qëllim përmirësimin e përmbajtjes dhe përgatitjes së informacionit për botimin e tij në shtypin ushtarak gjatë seminarit u trajtuan disa problematika të dala gjatë dokumentimit dhe publikimit të aktiviteteve kryesore të komandave dhe njësive.

Sensibilizimi

# Efektivat e batalionit të dytë të këmbësorisë dhurojnë gjak



Forca Tokësore krahas angazhimit në plotësimin e misionit kushtetues, mbrojtjes së sovranitetit, kontributit në mbështetje të paqes, japin një kontribut mjaft të rëndësishëm duke u bashkuar me vullnetarët e tjerë të dhurimit të gjakut…". Në kuadër të sensibilizimit për dhurimin vullnetar të gjakut ditën e enjte me datë 15.05.2014 në ambientet e Qendrës Shëndetësore të Spitalit Ushtarak të Forcës Tokësore, batalioni i dytë i këmbësorisë dhuroi gjak në mënyrë vullnetare.

Ky dhurim erdhi si rrjedhojë e bashkëpunimit të Seksionit të Shëndetësisë, Degës së BCU në Forcën Tokësore me komandën e batalionit, Kryqin e Kuq Shqiptarë dhe Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut. Kryqi i Kuq dhe Qendra e Transfuzionit të Gjakut, në mënyrë të vazhdueshme kanë bërë thirrje për dhurim gjaku për njerëzit që kanë nevojë për gjak, mungesa e të cilit vë në rrezik jetën e tyre…". Kësaj thirrje efektivat e batalionit i janë përgjigjur në vazhdimësi, duke u treguar të gatshëm për t'u bërë pjesë e iniciativave të tilla.

# "Biza-14", zhvillohet konferenca përfundimtare planëzuese





"Pas një pune përgatitore, arritëm në fazën përfundimtare të konferencës mbi Stërvitjen Certifikuese "BIZA-14" . Pa bërë studim, analizë, diskutim në nivel ekspertësh në sindikata nuk mund të arrijmë në zgjidhjet e duhura. Ndaj kërkoj nga të gjithë impenjim maksimal, disiplinë dhe mirëkuptim gjatë diskutimeve dhe debateve, si dhe propozime sa më profesionale për të arritur rezultatet e duhura…". Kështu e nisi fjalën e tij të mirëseardhjes zv/komandanti i Forcës Tokësore kolonel Dilaver Hoxha me rastin e zhvillimit të punimeve të Konferencës Përfundimtare Planizuese të Stërvitjes Certifikuese "Biza-14", zhvilluar në datat 8-9 Maj 2014, konferencë e cila kishte për objekt sinkronizimin e të gjitha veprimeve të deritanishme, duke shërbyer si një ndër instrumentet kryesor për mbarëvajtjen e stërvitjes "Biza 14", e cila do të zhvillohet në datat 18-27 qershor 2014 në rajonin e Bizës.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga Shtabi i Përgjithshëm i FA-së, shtabi i FT-së, ekipi i vlerësimit, nga audienca primare e stërvitjes shtabi dhe nënrepartet e b2k, audienca dytësore, batalioni komando, kompania mortajave, kimisë, struktura vartëse të Forcës Tokësore, nga kompania e xhenios, strukturë e Brigadës së Mbështetjes Rajonale, Forcat Ajrore dhe Policia Ushtarake. Në fjalën e tij kolonel Hoxha, theksoi se, tashmë përgatitja për stërvitjen ka hyrë në një fazë të re, të finalizimit të procedurave. Nëpërmjet konferencave të zhvilluara me pjesëmarrje të gjithë aktorëve që do të marrin pjesë në zhvillimin dhe ndjekjen e stërvitjes "Biza 14" në interes të stërvitjes janë zhvilluar disa konferenca, rikonicione dhe parapërgatitje. Midis të cilave përmendi Konferencën Fillestare të Planizimit, ku janë marrë njohuritë e përgjithshme mbi stërvitjen dhe detyrimet e strukturave përkatëse, si dhe është bërë njohja në mënyrë të përmbledhur me skenarin, strukturën dhe organizimin e këtij aktiviteti. Po ashtu Konferencën Kryesore, ku pas një përgatitje individuale dhe në bazë shtabi, reparti e nënrepartesh u thelluan njohuritë mbi organizimin e stërvitjes dhe specifikimet përkatëse, forcat pjesëmarrëse dhe situatat dhe aktivitetet përgatitore. Një masë e rëndësishme, theksoi ai, ishte zhvillimi i stërvitjes me temë "Batalioni i Këmbësorisë në Mbrojtje", në Qendrën e Simulimit në KDS. Punën me sindikata, sinkronizimin e veprimeve, si dhe sigurimin e bashkëpunimit ndërmjet strukturave e cilësoi si çelësi i suksesit të stërvitjes. Vëmendje e veçantë iu kushtua Analizës së kësaj faze dhe përmirësimit të rishikimit pas veprimit.

Më pas nënkolonel Beqir Tafili, shefi i Degës së Operacioneve dhe Stërvitjes i njohu të pranishmit në mënyrë të holësishme me programin e konferencës, specifikimet e stërvitjes, strukturën, situatat operacionale të kundërshtarit dhe forcave tona, ritmin e stërvitjes, statusin e përgatitjeve, punën në sindikata, ndarjen e detyrave, imputet, vlerësimet përkatëse. Konferenca përfundimtare Planizuese e Stërvitjes Certifikuese "Biza 14" u zhvillua në funksion të stërvitjes fushore 10 ditore "Biza 14", që ka për qëllim vlerësimin e aftësive operacionale të b2k, në organizim. Planizim, Komandim-Kontroll dhe zhvillimin e operacionit mbrojtës me qëllim final, certifikimin kombëtar të tij sipas sistemit CREVAL. Pjesëmarrja nga të gjitha strukturat dhe nivelet, vlerësimi që po i jepet kësaj veprimtarie nga drejtuesit e MM, SHP dhe Komandës së FT, tregon rëndësinë e stërvitjes dhe përgjegjësitë që kemi për certifikimin e b2k, duke e konsideruar si një sfidë të vitit . Tashmë objektivat tona për stërvitjen janë të qarta. Një sërë urdhrash e udhëzimesh në të gjitha nivelet e komandim kontrollit kanë dalë dhe po zbatohen. Një kujdes i veçantë ju kushtua masave të parashikuara për vlerësim, por edhe skenarëve të pa parashikuar dhe reagimi ndaj tyre. Një test i tillë do të jetë një instrument matës për të përcaktuar vlerat reale të aftësive operacionale të batalionit të dytë të këmbësorisë. Në ditën e dytë punimet e konferencës u zhvilluan nën drejtimin e kolonel Adi Ndoni, shef i Shtabit të Forcës Tokësore. Në konkluzionet përfundimtare, Ai vlerësoi angazhimin e të gjithë aktorëve pjesëmarrës në konferencë dhe vuri si detyrë që gjithçka e diskutuar në sindikata dhe nga grupi i vlerësimit të reflektohet në rishikim të skenarit, planizimin e stërvitjes, për të cilën porositi të zhvillohet një përnjohje në rajonin e Poligonit të Bizës, ku të precizohen detyrat në terren.

**Major Nexhbedin Basha**

# Kursi komando një sfidë, ku jo gjithkush certifikohet

## *Përfundoi kursi i 9-të komando i "Batalionit Komando"*




Brenda një harku kohor prej 6 muajsh, Batalioni Komando zhvilloi dy kurse funksionale. Në ceremoninë përmbyllëse të kursit të IX Komando mori pjesë zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, kolonel Dilaver Hoxha, përfaqësues nga shtabi i FT-së dhe Shkolla e Trupës. Pjesë e kësaj ceremonie krahas kursantëve ishte edhe efektivi i këtij batalioni. Në fjalën e hapjes Nënkolonel Besim Bala e konsideroi kursin komando, një ndër aktivitet kryesore të batalionit për vitin 2014, duke e cilësuar si një domosdoshmëri për rritjen e kapaciteteve operacionale të këtij reparti. Duke përfituar nga eksperienca e dy kurseve të mëparshme, thekson komandant Besimi, si dhe reflektuar nga mësimet e nxjerra, kërkesë imediate për kursin e 10-të Komando do jetë rishikimi i programit, përfshirja në këtë kurs i ushtarëve profesionistë të strukturave të FT-së, që përfundojnë stërvitjen SIA në Shkollën e Trupës Bunavi, me qëllim përzgjedhjen e individëve të certifikuar që dëshirojnë të shërbejnë në strukturat e Batalionit Komando. Në fjalën përshëndetëse, kolonel Dilaver Hoxha, zv.komandant i FT-së, pasi përcolli urimet dhe përshëndetjet e veçanta të komandantit të Forcave Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, vlerësoi punën e bërë nga komandanti i batalionit, deri tek anëtarët e shtabit dhe personeli i mbështetjes me shërbime, si dhe punën e komandantit të Kursit Kapiten Hazizi dhe e kursantëve që arritën të certifikohen. Kolonel Hoxha, mes të tjerave u shpreh, një pjesë e kursantëve arritën rezultatin e duhur, ndaj dhe e meritojnë certifikimin e sotëm. Pjesa tjetër nuk arriti të certifikohet, pasi aftësitë janë komplekse dhe nuk mund të merren të shkëputura. Pati dhe nga ata që e lanë garën. Gjëja e parë që duhet vlerësuar është dhënia përgjigje e pyetjeve: sa u arrit objektivi? apo a jemi të kënaqur me ketë rezultat? Domosdoshmërisht që kjo kërkon analizë, për seriozitetin individual si dhe aftësitë që kemi për të merituar "titullin Komando". Ja vlen ta përsëris dhe ta ngulitim në mendje se Kursi Komando është një sfidë, ku jo gjithkush që hyn në garë mund ta fitojë atë, për pasojë dhe kursi ishte selektiv…". Unë dua ti referohem një ndër rregullave bazë për ushtarakët, të cilën e përmban rregullorja rreshtore "..Ushtaraku e gjen vendin e tij në rresht me shpejtësi dhe në kohën e duhur….". E përmend këtë theksoi ai, se Kursi Komando për vetë ngarkesën që ka, rubrikat që mbart për plotësim, kërkon angazhim, seriozitet, disiplinë që jo të gjithë e arrijnë. Kjo përbën mbijetesën për të përballuar mbingarkesën. Janë të shumtë ata që e dëshirojnë beretën Komando, por ajo është e limituar në numër dhe jo çdo kush e merr. Ju keni të dy anët e medaljes, së pari krenarinë e të qenit Komando dhe së dyti, vështirësinë për ta mbajtur atë, e cila bën edhe diferencën nga të tjerët. Pas kësaj ceremonia vijoi me shpërndarje të certifikatave.

N. Basha

Fjalimi i Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, në Universitetin Tallinn, Estoni

# Mbrojtja e aleatëve, ndarja e përgjegjësive, ruajtja e vlerave

## *Rasmussen: Angazhimi i NATO-s ndaj mbrojtjes kolektive është i fortë si shkëmb dhe i tillë do të mbetet*




"Para së gjithash falënderoj Urmas për mikpritjen. Kam kënaqësinë të ndodhem përsëri në Estoni si dhe të ndodhem përsëri në Universitetin e Tallinn. Kam kujtime gjatë vizitës sime të fundit zyrtare si Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s dy vjet më parë. Për fat të keq, kontinenti ynë sot është më pak i qëndrueshëm dhe më pak i sigurt se sa kur isha këtu herën e fundit. Tani ne po përballemi me një situatë të re dhe shqetësuese për sigurinë në Europë. Presidenti Putin dhe qeveria e tij kanë treguar përbuzje të plotë ndaj të drejtës ndërkombëtare, rendit ndërkombëtar dhe institucioneve ndërkombëtare. Veprimet e fundit të Rusisë në Ukrainë janë të egra. Ato janë të papërgjegjshme e të paligjshme, por kriza me të cilën po përballemi sot nuk ka të bëjë vetëm me agresionin e Rusisë ndaj Ukrainës. Duke treguar gatishmëri për të përdorur forcën për të trembur e pushtuar fqinjët e saj si dhe duke deklaruar një doktrinë për mbrojtjen e rusisht-folësve kudo, Rusia ka krijuar pasiguri e paqëndrueshmëri në të gjithë kontinentin tonë e në të gjithë zonën euroatlantike. Në të njëjtën kohë, në një përpjekje të dobët për të shpjeguar e justifikuar sjelljen e saj, Rusia ka manipuluar mediat e saj dhe ka bërë propagandë patetike rreth NATO-s. Sot kam ardhur këtu për të hedhur poshtë mitet ruse e për të shpjeguar se çfarë bëjmë në NATO dhe pse e bëjmë. Së pari, çfarë bëjmë në NATO. Ne ruajmë çdonjërin prej 28 vendeve tona aleate. Ky angazhim është sanksionuar në nenin 5, klauzola e mbrojtjes kolektive e traktatit tonë të themelimit. Ajo është në qendër të asaj që jemi ne si Aleancë dhe të asaj që ne bëjmë së bashku si aleatë. Nuk duhet të ketë absolutisht gabime apo keqkuptime nga asnjë: Neni 5 është një shkëmb angazhimi solid. Ne do të bëjmë gjithçka duhet për të mbrojtur çdo pjesë të territorit tonë dhe për të mbrojtur çdo person në mesin e popullatës tonë. Kjo është pikërisht ajo që kemi bërë. Kohët e fundit, ne kemi ndërmarrë një numë hapash për të reaguar ndaj sjelljes agresive të Rusisë dhe për të treguar qartë zgjidhjen dhe përkushtimin tonë kolektiv. Këtu, në rajonin e Baltikut, tashmë ne kemi përforcuar misionin tonë të mbikëqyrjes ajrore dhe praninë tonë detare. Gjithashtu, ne kemi vendosur avionë mbikëqyrës AWACS mbi Poloni dhe Rumani. Ne do të vazhdojmë të mbikëqyrim veprimet e Rusisë pranë kufijve tanë dhe jemi të përgatitur të ndërmarrim hapa të mëtejshëm nëse do të jetë e nevojshme. Kjo përfshin përforcimin e planeve tona të mbrojtjes, rritjen e gatishmërisë së forcave tona, duke përfshirë dhe Forcën e Reagimit të NATO-s, intensifikimin e stërvitjeve tona si dhe rishikimin e sjelljes dhe pozicionimin e forcave tona. Të gjitha këto me qëllim përforcimin e mbrojtjes sonë kolektive. Në përgjigje të hapave mbrojtës së kemi ndërmarrë, presidenti Putin dhe udhëheqës të tjerë rusë kanë deklaruar se NATO nuk ka të drejtë të përforcojë aleatët tanë në këtë pjesë të botës. Më lejoni të jem i qartë: Kjo është thjesht e gabuar! Në aktin themelues NATO-Rusi të vitit 1997, ne ramë dakord se, po citoj: "Në mjedisin e tanishëm e të paparashikueshëm të sigurisë", fundi i citimit, Aleanca do të sigurojë mundësinë për të kryer mbrojtjen kolektive nëpërmjet përforcimit dhe infrastrukturës adekuate, ne vend të "stacionimit të përhershëm të forcave së konsiderueshme luftarake". NATO e ka përmbushur plotësisht këtë angazhim. Duke punuar me aleatët tanë të rinj ne kemi siguruar infrastrukturën e nevojshme duke përmirësuar për shembull bazat ajrore në këtë vend dhe në Lituani. Rusia nuk duhet të ankohet për këtë.

Për më tepër, Akti i Themelimit në mënyrë specifike thotë se "përforcimi mund të ndodhë, kur të jetë e nevojshme, në rast mbrojtjeje kundër një kërcënimi agresioni". Kjo është ajo që kemi deklaruar në Aktin Themelues NATO-Rusi dhe tani ne shohim me të vërtetë një kërcënim. Fakti është se mjedisi i sigurisë ka ndryshuar në mënyrë dramatike. Pra, NATO po ndërmerr hapa të ligjshëm mbrojtjeje kundrejt paqëndrueshmërisë së krijuar nga veprimet e paligjshme agresive të Rusisë. Pra, kjo është ajo që ne bëjmë në NATO: Garantojmë sigurinë e çdo aleati. Angazhimin e mbrojtjes kolektive e tregojmë nëpërmjet përgjegjësisë kolektive. NATO është një komunitet i demokracive ku çdo aleat luan pjesën e vet dhe çdo aleat kontribuon në përgjegjësinë tonë kolektive. Kjo është ajo që e quajmë solidaritet dhe kjo është forca e vërtetë dhe reale e Aleancës sonë. Të jesh anëtar i NATO-s nuk është vetëm një privilegj, por është gjithashtu një detyrë. Nuk është vetëm të gjithë për një, por është dhe një për të gjithë. Nuk ka të bëjë vetëm me faktin se disa aleatë ndihmojnë disa të tjerë, por ka të bëjë me faktin se të gjithë aleatët janë të gatshëm të ndihmojnë çdo aleat. Me këtë ka të bëjë mbrojtja kolektive në NATO. Pjesë e kësaj përgjegjësie kolektive është të jesh i gatshëm për t'ju përgjigjur të gjithë rreziqeve e kërcënimeve të ndryshme më të cilët përballemi sot. Kjo nuk përfshin vetëm sjelljen aktuale të Rusisë. Gjithashtu, ajo përfshin armët e reja dhe shtetet e dobëta, piratët e përhapjen si dhe raketat. Në mënyrë që të merremi me këtë gamë të gjerë sfidash, Koncepti ynë Strategjik identifikon tre detyra kryesore për NATO-n: Mbrojtjen kolektive, menaxhimin e krizave dhe sigurinë bashkëpunuese dhe të tre këto detyra janë të vlefshme. Në të vërtetë, ato përforcojnë njëra-tjetrën, sepse për të përforcuar sigurinë tonë, duhet të jemi të përgatitur të trajtojmë krizat jashtë vendit si dhe duhet të jemi në gjendje të bëjmë më shumë se një gjë në të njëjtën kohë. Kjo do të thotë se duhet të punojmë ngushtë me partnerët. Gjithashtu, do të thotë se duhet të kemi një spektër të gjerë aftësish, sepse asetet si Forcat Speciale, dronët dhe avionët e transportit janë të rëndësishëm për të tre këto detyra. Kjo ka lidhje me reagimin tonë të shpejtë, së bashku dhe në mënyrë efektive kundrejt të gjithë kërcënimeve, kudo dhe kurdo që mund të ndodhin, duke përfshirë këtu dhe rajonin e Baltikut. Secili prej 28 aleatëve tanë, qofshin të mëdhenj apo të vegjël, duhet të marrë përsipër përgjegjësi, jo domosdoshmërisht të zhvillojë të gjitha ato aftësi të ndryshme mbi veten, por të luajë rolin e tij të plotë për të qenë i sigurt që ne kemi ekses mbi të gjithë ato në NATO. Estonia ka dhënë një kontribut të madh në operacionet tona të NATO-s, veçanërisht në Afganistan. Ju keni marrë udhëheqjen duke e bërë sigurinë kibernetike një pjesë të plotë së përpjekjeve të mbrojtjes sonë kolektive dhe keni rritur shpenzimet e mbrojtjes së qëllimit të NATO-s me 2% të prodhimit tuaj të brendshëm bruto. Duke bërë gjithë këtë, Estonia ka dhënë një shembull të shkëlqyer dhe jam i kënaqur që Letonia, Lituania dhe Rumania kanë njoftuar se do të rrisin shpenzimet e tyre si dhe jam i bindur se dhe aleatë të tjerë do ta bëjnë këtë, sepse mbrojtja vlen, siguria dhe liria janë të çmuara e kjo nuk vjen falas. Ne udhëhiqemi nga dëshira për të mbrojtur vlerat, territorin dhe njerëzit tanë. Lirinë, demokracinë, shtetin e së drejtës ndërkombëtare, paprekshmërinë e kufijve si dhe të drejtën e kombeve për të vendosur marrëveshjet e tyre të sigurisë. Këto vlera e norma janë esenciale për mënyrën tonë të jetesës. Këto vlera janë në qendër të Kartës së Kombeve të Bashkuara të vitit 1945, në qendër të Aktit Final të Helsinkit të vitit 1975 dhe Kartës së OSBE-së për Sigurinë Europiane të vitit 1999. Ato janë themelet e paqes dhe stabilitetit në të gjithë zonën euroatlantike. Ne kemi ndërtuar një sistem ndërkombëtar bashkëpunues të bazuar në vlera e norma dhe Rusia ka qenë pjesë e kësaj. Rusia ka përfituar nga transparenca, parashikueshmëria dhe stabiliteti i këtij sistemi, por tani Rusia po i shkel këto vlera të vërteta. Në përpjekje për të mbrojtur veprimet e tyre të paligjshme në Ukrainë, udhëheqësit rusë kanë sulmuar legjitimitetin e operacioneve të NATO-s në Libi e Kosovë, por ata kanë keqinterpretuar faktet. Në Libi, operacioni ynë nisi nën autoritetin e Rezolutave 1970 dhe 1973 së Këshillit të Sigurimit së Kombeve të Bashkuara dhe kryem operacionin tonë të Kosovës me qëllim parandalimin e genocidit, në përputhje me parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara. Në të kundërt, në Krime, pa dëshmi të një krize dhe pa përpjekje për të negociuar çdo formë zgjidhjeje, Rusia thjesht ka zënë një pjesë së territorit të Ukrainës në një shkelje flagrante të rregullave e angazhimeve ndërkombëtare. Udhëheqësit rusë kanë pohuar gjithashtu se duke e mbajtur derën hapur për anëtarët e rinj, NATO ka rrethuar e kërcënuar Rusinë. Realiteti është se NATO është rritur nga 12 anëtarë në vitin 1949 kur NATO u themelua deri në 28 anëtarë që ajo ka sot, jo sepse ne e nxitëm zgjerimin, por sepse 16 vende dëshironin të bashkoheshin dhe sepse ata e ushtruan të drejtën e tyre sovrane për të bërë këtë zgjedhje. Për më tepër, zgjerimi i NATO-s ka qenë në të vërtetë i mirë për Rusinë në drejtim të tregtisë, investimeve dhe sigurisë. Për më shumë se dy dekada, NATO ka punuar vazhdimisht për të ndërtuar një marrëdhënie bashkëpunuese me Rusinë në fushat me interes të përbashkët. Me Aktin Themelues NATO-Rusi, Deklaratën e Romës dhe me Këshillin NATO-Rusi në samitin e Lisbonës, NATO ka treguar dëshirën tonë të sinqertë për të ndërtuar një partneritet të vërtetë strategjik me Rusinë. Fjalimi im i parë publik si Sekretar i Përgjithshëm ishte rreth rëndësisë për të ndërtuar një marrëdhënie të tillë të fortë dhe reciprokisht të besueshme dhe ne kemi propozuar masa të shumta konkrete, të tilla si bashkëpunimi rreth mbrojtjes raketore. Në çdo hap, ne jemi përpjekur të përfshijmë Rusinë. Aspirata afatgjatë e NATO-s ka qenë zhvillimi i një partneriteti të vërtetë strategjik me Rusinë, por Rusia nuk është përgjigjur në mënyrë konstruktive. Më vjen keq që Rusia e sheh aktualisht NATO-n si një kundërshtare dhe jo si një partnere. Kjo nuk është një qasje që ne e përkrahim dhe jemi të gatshëm për t'u përballur me çdo sfidë. Me lejoni të përfundoj me dy mesazhe të qarta. Mesazhi im i parë është për Rusinë: Bëj hapa mbrapa. Bashkohu me sistemin ndërkombëtar dhe përmbush angazhimet e tuaja ndërkombëtare, sepse këto janë kritike për sigurinë dhe stabilitetin tuaj të ardhshëm si dhe të asaj të kontinentit tonë të përbashkët dhe të të gjithë botës. Gjithashtu, kam një mesazh për Estoninë dhe fqinjët e saj baltikë: NATO qëndron me ju. Ju mund të jeni në kufirin e NATO-s gjeografikisht, por jeni në qendër të Aleancës politikisht. NATO do ju mbrojë ju dhe të gjithë aleatët. Ne do të bëjmë atë që duhet për të mbrojtur popullsinë dhe shoqëritë tona kundrejt çdo lloj kërcënimi. Angazhimi i NATO-s ndaj mbrojtjes kolektive është i fortë si shkëmb dhe i tillë do të mbetet".

**Alba Musaraj**
**burimi: NATO.int**

# Ukraina në prag të zgjedhjeve të 25 majit

MIMOZA GOLIKJA




*Vëmendja e Rusisë, Shteteve të Bashkuara, Evropës dhe NATO-s është drejtuar në Ukrainë. Edhe pse aftësia për të rivendosur autoritetin legjitim është në duart e qeverisë së Kievit, Kievi duket i vendosur për të përdorur forcën e armëve, ndërkohë legjitimiteti nuk mund të vendoset nga gryka e pushkëve.*



Ngjarjet panoramike në Ukrainë dhe ajo që ndodh nga dita në ditë tregojnë se lufta civile është e pashmangshme. Mediat ukrainase të lajmeve njoftojnë se militantët separatistë janë përdorur si mburoja njerëzore, duke të krijuar idenë e konfuzionit dhe të pasigurisë. Në nëntor të vitit 2013, presidenti Viktor Janukoviç shtypi protestat, në janar iu përgjigj me dhunë protestuesve dhe në shkurt snajperët e policisë vranë më shumë se 100 protestues. Në 21 shkurt Janukoviç u rrëzua. Ndarja ishte e qartë në historinë post sovjetike të Ukrainës. Filozofi Thomas Hobbes ka shkruar me elokuencë për jetën "në mungesë të autoritetit politik", por ai nuk ka mundur të parashikonte frakturat moderne të fakteve dhe tregimeve që e shoqërojnë rënien e tij. Sot në Ukrainë autoriteti në të gjitha format e tij jo vetëm që mungon por tashmë ai është degraduar. Mungesa e konsensusit rreth ngjarjeve kritike dhe degradimi i autoritetit legjitim politik tashmë udhëtojnë së bashku. A do të mundet Ukraina (qoftë dhe me ndërhyrjen ruse), të rivendosë legjitimitetin për udhëheqjen e saj tashmë kur ajo është në prag të luftës civile? Ndërkohë në Ukrainë, ka vëzhgues të OSCE por forcat e qeverisë së Kievit dhe separatistët pro ruse i kufizojnë lëvizjet e tyre. Vëmendja e Rusisë, Shteteve të Bashkuara, Evropës dhe NATO-s është drejtuar në Ukrainë. Edhe pse aftësia për të rivendosur autoritetin legjitim është në duart e qeverisë së Kievit, Kievi duket i vendosur për të përdorur forcën e armëve, ndërkohë legjitimiteti nuk mund të vendoset nga gryka e pushkëve. Legjitimiteti vjen me zgjedhje të drejta dhe zgjedhjet në Ukrainë janë planifikuar më 25 maj.

### Lufta e Ftohtë dhe kriza e Ukrainës

Fundi i Luftës së Ftohtë filloi me Rënien e Murit të Berlinit (9 nëntor 1989) dhe përfundoi me shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik (08-25 dhjetor 1991). Ky fund solli dhe supozimin se lufta konvencionale midis kombshteteve të zhvilluara kishte përfunduar në mënyrë të arsyeshme. Qëllimi kryesor i ushtrisë do të ishin operacione të ndryshme si ruajtja e paqes, ndihma në raste fatkeqësish si dhe lufta për ndryshimin e regjimeve shtypëse. Pas 11 shtatorit, u fol shumë mbi luftën asimetrike dhe "luftën e gjatë". Shtetet e Bashkuara do të angazhoheshin për një kohë shumë të gjatë, në veprimtaritë kundër terrorizmit në një zonë të gjerë të botës islame dhe nën këtë vështrim konfliktet dukeshin të vjetruara. Çdo shekull, (dominuar gjithnjë nga Evropa që nga shekulli i 16-të), ka pasur luftëra sistematike në të cilat kanë marrë karakter ndërkombëtar si shekulli i 20-të, me dy luftërat botërore, shekulli i 19 luftërat e Napoleonit, si dhe luftërat e shekullit të 18. Për gati një gjysmë shekulli arkivat sovjetike dhe ukrainase kanë qenë të mbyllur për historianët, ndryshe nga sot kur është e mundur për të bërë kërkime shkencore në Ukrainë dhe Moskë duke bërë më në fund të mundur dhënien e një tabloje më të saktë. Pothuaj çdo familje ukrainase ka pësuar humbje në luftë dhe shumë nga ato kanë viktima edhe të Hitlerit edhe të Stalinit. Ukraina ka mijëra monumente të Luftës së Dytë Botërore. Fshatra shumë të vegjël shpesh kanë në monument listat e emrave të të vdekurve të Luftës së Dytë Botërore. Humbjet Ukrainës regjistruan ndoshta 10 milionë ose gjysmën e të gjithë totalit BRSS dhe njëzet për qind të të gjithë totalit të Luftës së Dytë Botërore dhe pesëdhjetë milionë të vdekur. Ajo u dëmtua rëndë nga lufta, dhe kjo kërkoi përpjekje të mëdha për tu rimëkëmbur. Më shumë se 700 qytete dhe qyteza dhe 28.000 fshatra u shkatërruan. Kriza e Ukrainës filloi kur presidenti i Ukrainës Viktor Janukoviç, u detyrua të largohet nga vendi dhe të kërkojë strehim në Rusi (ai u largua në Kiev gjatë natës së 21 shkurt 2014). Aneksimi i mëvonshëm rus i Krimesë, pas një referendumi popullor që tregoi se shumica e popullsisë ishte në favor të një kthimi në Rusi përkeqësoi marrëdhëniet e tensionuara me Perëndimin. Gadishulli i Krimesë kishte qenë në fakt pjesë e sferës ruse që kur ajo ishte aneksuar nga Perandoresha Katerina e Madhe në 1783. Më pas gati dy shekuj më vonë, në vitin 1954, lideri sovjetik Nikita Hrushovi e transferoi gadishullin e Krimesë nga Republikë Federative Socialiste Sovjetike e Rusisë në Republikë Socialiste Sovjetike të Ukrainës. Tani edhe një herë, Krimea është pjesë e Federatës Ruse. Në këto momente rajoni lindor pro rus i Ukrainës është në qendër të medias dhe në skenën e një konflikti të përgjakshëm, një konfrontim në mes të qeverisë qendrore të Ukrainës dhe rebelëve pro ruse të Ukrainës. Situata në Ukrainën lindore po shndërrohet gjithnjë e më shumë në më e dhunshme, sidomos tani që zgjedhjet janë planifikuar të mbahen më 25 maj.

### Kriza e Ukrainës nuk do të sjellë luftë në Evropë

Profecia e Bismark kur paralajmëroi në vitin 1898 se në qoftë se do të kishte ndonjëherë luftë të madhe në Evropë ajo do të vinte nga Ballkani u përmbush në vitin 1914, nga vrasja në Sarajevë. Por Evropa ka ndryshuar. Lufta Botërore e ardhshme, çfarëdo që të ndodhë në javët e ardhshme dhe muajve, nuk do të vijë nga Ukraina (që është pak në verilindje të Ballkanit ). Rusia mund të pushtojë Ukrainën, mund të ketë një luftë të re të ftohtë për një kohë, por nuk do të ketë luftime në Evropë përtej kufijve të Ukrainës. Përveç Ballkanit, Evropa 70 vitet e fundit, nuk ka pasur luftë në shkallë të gjerë edhe kur në vitet 1990 mendohej se luftimet do të përhapeshin përtej kufijve të ish Jugosllavisë. Dy herë në 30 vjet, në 1914-1918 dhe 1939-1945, lufta e madhe duke përdorur armë moderne të kohës, preku pothuajse të gjithë territorin e Evropës. Në rastin e parë, humbi një brez i të rinjve dhe në rastin e e dytë, shumica e vendeve nga Gjermania në drejtim të lindjes kanë pasur rreth 10 % e popullsive të tyre të vrarë dhe shumica e viktimave ishin civilë. Gjysma e qyteteve të mëdha historike të kontinentit u reduktuan në rrënoja edhe pa ndihmën e armëve bërthamore. Ky ishte një mësim i paguar shumë shtrenjtë dhe evropianët këtë e dinë mirë. Nëse rusët duan një pjesë ose të gjithë Ukrainën, ata edhe mund të kenë, por për ta marrë atë në këtë rast do të paguanin një çmimin afatgjatë, i cili do të ishte shumë i lartë. Por asgjë në Evropë që është me vlerë nuk do të hidhet në erë. Fakti se trupat dhe avionët nga Shtetet e Bashkuara dhe Kanadaja janë dërguar në vendet e NATO-s që kanë kufij me Rusinë tregon se qëllimi është i thjeshtë, për t'i kujtuar rusëve se aleanca do të mbrojë anëtarët e saj. Moska ka konfiskuar Krimenë, dhe po luan me idenë e kapjes së Ukrainës, pikërisht për shkak se vendi nuk është nën ombrellën NATO-s .

Është hera e parë që Ukraina në 350 vitet e fundit ka qenë e pavarur

*Kriza e Ukrainës filloi kur presidenti i Ukrainës Viktor Janukoviç, u detyrua të largohet nga vendi dhe të kërkojë strehim në Rusi (ai u largua në Kiev gjatë natës së 21 shkurt 2014). Aneksimi i mëvonshëm rus i Krimesë, pas një referendumi popullor që tregoi se shumica e popullsisë ishte në favor të një kthimi në rusi përkeqësoi marrëdhëniet e tensionuara me Perëndimin.*







nga Rusia. Qeveritë post- sovjetike në Kiev kanë rezultuar të korruptuara dhe të paafta dhe si rezultat vendi ka qenë edhe më i varfër se sa ishte në kohën e Bashkimit Sovjetik dhe për 20 vjet Rusia pak a shumë e ka respektuar pavarësinë e Ukrainës. Ajo është anëtare e OKB-së. Situata e Ukrainës mund të bëhet e rrezikshme, por ajo nuk do të ta çojë Evropën në luftë. Evropa duke përfshirë edhe Rusinë, nuk ka dinamikën demografike, ekonomike, ushtarake, politike dhe gjeopolitike të së kaluarës. Evropa ka arritur në një fazë post moderne e cila i ka zhvendosur epokat e hershme të perandorive, ushtrive dhe ideologëve. Vera e vitit 1914 është e pamundur të imagjinohet në vitin 2014. Megjithatë, kriza e Ukrainës demonstron se si anija globale është në det të trazuar pa timon, pa një busull të duhur, dhe pa pilot të duhur. Kriza ukrainase nuk është një shenjë paralajmëruese e një lufte të re të ftohtë apo në ndonjë mënyrë një kthim të Evropës në fazën e qendrës globale. Më saktë, ajo jep edhe një ilustrim flagrant të faktit se në lidhje me qeverisjen globale bota është bërë një tranzicion më kaotik në një çrregullim të ri global.

Ukraina është një vend në buzë të vendeve të tjera nëse shohim historinë e saj, vërejmë se ajo ka qenë ndonjëherë pjesë e njërit vend dhe ndonjëherë pjesë e tjetrit e më shpesh e ndarë. Në shekujt e 17 dhe 18, ajo ishte e ndarë në mes të Rusisë, Polonisë dhe Perandorisë Osmane. Në shekullin e 19, ajo ishte e ndarë në mes të Rusisë dhe Austro-Hungarisë. Në shekullin e 20, për një periudhë të shkurtër kohe ka ruajtur pavarësinë e pas Luftës së Parë Botërore, ajo u bë pjesë e Bashkimit Sovjetik. Ukraina ka qenë me shekuj në hap të perandorive. Në Luftën e dytë Botërore në vitin 1941 ishin gjermanët deri sa sovjetikët u kthye në vitin 1944. Ukraina është një prej vendeve evropiane që ka vuajtur më shumë në shekullin e 20- të. Ngjarjet e shpejta të paligjshmërisë dhe dhuna e ushtruar që ka marrë jetën e dhjetëra njerëzve në qytetet e Ukrainës, Donetsk, Slovyansk dhe Odessa në javët e fundit është një alarm për kryeqytetet perëndimore. Strategjia e Washingtonit dhe Evropës është fokusuar te thirrja që i bën Putinit që të tërheqë mbështetjen për separatistët, dhe kërcënon sanksione të tjera nëse atje situata nuk ndryshon. Mirëpo a po ndalon kjo vrasjet, a po parandalon copëtimin de facto të Ukrainës? A do të pengojë kjo Putinin që të vazhdojë të luajë rolin që ai dhe Rusia po luajnë në këtë proces?

**Rusia autokratike, Ukraina dhe Evropa**

Eksperimentet e shkurtra dhe të rralla të Rusisë për demokraci kanë dështuar, ishte qeveria e Aleksandrit Kerenskit në vitin 1917, ajo që çoi në revolucionin bolshevik dhe ajo nga Boris Jelcin në vitet 1990 në neoczardom Vladimir Putin. Rusia ka qenë autokraci duke pasur parasysh mizorinë e plotë të carëve dhe komunistëve. Gjithashtu Putin tani paraqet një autokrat në krizë, një histori kjo e njohur në Rusi dhe problemet e tij janë për pjesën më të madhe të pazgjidhshme, njëlloj si ato me të cilat janë përballur autokratët rusë para tij. Kontrolli i fatit përfundimtar të Ukrainës është i një rëndësie të madhe për të, për arsye gjeografike dhe historike. Dendësia e popullsisë së Ukrainës dhe pozita gjeografike e bëjnë atë një strumbullar vendimtar për Kremlinin, nëse dëshiron dominim të përhershme mbi Evropën Lindore dhe Detin e Zi. Megjithatë, Putin konstaton se ai nuk mund të kontrollojë plotësisht Ukrainën apo më tej të minojë sovranitetin e saj. Nuk është thjesht një element shumë thelbësor në politikën e Ukrainës dhe të shoqërisë që kërkon një ndryshim më afër Evropës dhe Bashkimit Evropian. Putin ka mjete të ndryshme për të minuar Ukrainën, të tilla si ngritjen e barrierave tregtare dhe dërgesat e racionimit të gazit natyror. Por kjo është e vështirë, dhe ai ndoshta kurrë nuk mund të arrijë një fitore të plotë. Putin frikësohet në perëndim, pro- NATO-s dhe pro – BE-së, ai frikësohet nga emocionet brenda ish-republikave sovjetike të Gjeorgjisë dhe Moldavisë. Ai ka frikë trazirat në ish republikat sovjetike të Azisë Qendrore, ku në mënyrë të besueshme autokratike, regjimet sovjetike mund të përballen shpejt me rritje të trazirave nëpërmjet duarve të fondamentalistëve islamikë, Putini nuk do të donte që të të mund të destabilizonte vetë Rusinë. Rusia ka nevojë për stabilitet dhe përputhshmërinë e saj brenda dhe në afërsi të kufijve të saj. Putin jo vetëm ka shqetësime në lidhje me pozicionin e mundshëm të Rusisë së përkeqësuar në tregjet botërore të energjisë në një afat të gjatë, por gjithashtu dhe njëfarë peshe në rritjen demografike të myslimanëve në shoqërinë ruse për afat të gjatë.

Shtetet e Bashkuara njoftuan sanksione të reja mbi shtatë zyrtarë të qeverisë ruse më 28 prill. Një taktikë e gjatë e përdorur ku sanksionet mund të japin efekte të paparashikueshme ose nuk kanë efekt në të gjitha rastet, në varësi se si ato janë hartuar. Supozohet se zakonisht sanksione zbatohen kur veprimet dhe synimet e një vendi konsiderohen të papranueshme. Kombet me sa duket zgjedhin sanksionimin të vendosin sanksione për të shmangur luftën kur lufta do të jetë shumë më e kushtueshme ose kur ajo mund të rezultojë në humbjen. Qëllimi i deklarimit të Sanksioneve është për të nxitur ndryshime të sjelljes në një shtet me synim për t'i shkaktuar dhimbje ekonomike. Për të funksionuar sanksionet duhet pra që ato të shkaktojnë dhimbje. Protestat e Euromejdanit ("Eurosheshit") filluan në nëntor 2013, atëherë kur qytetarët e Ukrainës kërkuan integrim më të fuqishëm në Bashkimin Evropian. Demonstratat u nxitën nga refuzimi për të nënshkruar një marrëveshje asocimi me BE-në, të cilën Janukoviçi e quajti si të pafavorshme për Ukrainën. Ndërkohë, demonstratat vazhduan në Euromejdan dhe trazira të tjera civile në Ukrainë, qëllimi i të cilave evoluoi për të përfshirë thirrjet për dorëheqjen e presidentit Janukoviç dhe qeverisë së tij. Dhuna u përshkallëzua pas 16 janarit 2014, kur qeveria pranoi ligjet Bondarenko-Olijnik, të njohur edhe si ligje anti-protestë. Demonstruesit anti-qeveritarë zunë ndërtesat në qendër të Kievit, duke përfshirë edhe ndërtesën e Ministrisë së Drejtësisë dhe trazirat lanë 98 të vdekur dhe mijëra të plagosur në 18-20 shkurt. Për shkak të protestave të dhunshme më 22 shkurt 2014, anëtarët e Parlamentit e konsideruan presidentin jo në gjendje të përmbushë detyrat e tij si dhe e shkarkuan atë, parlamenti ushtroi kompetencat kushtetuese për të thirrur zgjedhjet në 25 maj për të zgjedhur zëvendësuesin e tij. Më 1 mars, parlamenti i Rusisë miratoi kërkesën e ardhur nga Presidenti Vladimir Putin që lejonte dislokimin e trupave ruse në Ukrainë, në përgjigje të krizës së Krimesë. Trupat ruse u mobilizuan në të gjithë Krimenë dhe juglindje të Ukrainës. Shumica e botës perëndimore i dënoi këto veprime.

Ukraina ndodhet sot përsëri në një situatë duke u përpjekur për të gjetur hapësirë. Kjo ndodh përsëri në buzë të Rusisë dhe në buzë të Evropës, në pozitën e saj të vjetër. Por ajo çfarë e bën këtë pozicion unik është se Ukraina është e pavarur dhe ka qenë kështu për 18 vjet. Kjo është periudha më e gjatë e pavarësisë së Ukrainës në shekuj. Ajo që është më e habitshme në lidhje me ukrainasit është se, ndërsa ata duhet të vlerësojnë pavarësinë e tyre, debati i brendshëm është përqendruar në atë se njerëzit në perëndim duan të jenë pjesë e Bashkimit Evropian, ndërsa njerëzit në lindje duan të jenë më afër me rusët. Dijetarët ende nuk pajtohen nëse origjina e emrit të Ukrainës do të thotë "tokë kufitare" apo "atdhe". E me sa duket ukrainasit duan të mbeten të pavarur, por jo thjesht të pavarur. Moska është rikthyer në një strategji për të ringritur sferën e saj të influencës në zonat e ish-Bashkimit Sovjetik si dhe shqetësimi kryesor i Rusisë së sotme për të rindërtuar shtetin rus dhe rikthimin e forcës ruse në rajon.



*Profecia e Bismark kur paralajmëroi në vitin 1898 se në qoftë se do të kishte ndonjëherë luftë të madhe në Evropë ajo do të vinte nga Ballkani u përmbush në vitin 1914, nga vrasja në Sarajevë. Por Evropa ka ndryshuar. Lufta Botërore e ardhshme, çfarëdo që të ndodhë në javët e ardhshme dhe muajve, nuk do të vijë nga Ukraina*

DËSHMORËT E AVIACIONIT

# Dy pilotë "Dëshmorë të Atdheut", shpallen "Qytetar Nderi" të Vlorës

*Me rastin e përvjetorit të rënies në krye të detyrës të Dëshmorëve të Atdheut Shyqëri Balla dhe Kaso Petoshati*

**ALEKSANDËR ÇALA**

Historia e Aviacionit Luftarak Shqiptar është histori e guximtarëve, e njerëzve me ambicie për ecjen përpara. Aviacionit tonë nuk i kanë munguar guximtarët dhe heronjtë. Në piedestalin e nderit të aviacionit shqiptar kanë shkruar emrin e tyre shumë "Dëshmorë të Atdheut", mosha mesatare e të cilëve është 31 vjeç. Aviatorët veteran kujtojnë punën dhe sakrificat e shumta që kanë bërë në vite, shokët e armës, ata që janë midis nesh, por edhe ata që mbetën përjetësisht qiellit të kaltër të Shqipërisë, krenarinë dhe nderin e aviacionit, dëshmorët. Respekti për të rënët, këta djem e burra trima, është respekti për historinë e kombit, histori të cilën shumë pilotë e kanë shkruar me gjakun e tyre në lule të rinisë. Gjeografia e vendlindjes së dëshmorëve, por edhe e reparteve ku ata shërbyen me devotshmëri përfshin gjithë Shqipërinë. Fidanishtja e përgatitjes së pilotëve dhe teknikëve të aviacionit shqiptar, Shkolla e Aviacionit që si ditë të krijimit të saj shënon 11 majin i vitit 1962 ka një histori të lavdishme. Për të punuar e drejtuar në këtë shkollë u përzgjodhën drejtuesit, pilotët dhe pedagogët më të mirë që kishte për momentin Aviacioni Luftarak Shqiptar. Nga kjo shkollë janë përgatitur rreth 1300 pilotë, teknikë dhe specialistë të cilët shërbyen në radhët e Forcës Ajrore me dinjitet e devotshmëri për mbajtjen në gatishmëri e zhvillimin e aviacionit luftarak shqiptar. Një ditë pasi kishin vendosur lule e nderuar Dëshmorët e Atdheut në qytetin hero të Vlorës, efektivi i Shkollës së Aviacionit, i kthehet punës e praktikës intensive të fluturimeve. Në një ditë të bukur pranvere, si ajo e 6 majit 1971, pista e aerodromit fushor të Akërrnisë gumëzhinte nga gjallëria e njerëzve me uniform dhe zhurma e avionëve mësimorë. Kishte mbi një vit që kryhej dhe përgatitja e studentëve pilotë për fluturimet natën dhe për pasoj intensiteti dhe sasia e fluturimeve ishte maksimale. Fluturimet fillonin herët paradite e sipas planit kur kishte stërvitje dhe fluturime natën ato vazhdonin pa ndërprerje deri natën vonë. Ndërkohë që nata kishte rënë kudo e në qiell shkëlqejnë yjet e largët, niset në fluturim avioni i pilotuar nga piloti instruktor Kaso Petoshati dhe në bord shefin e shtabit të Shkollës së Aviacionit Shyqëri Balla. Nga pista dallohet vetëm sinjali i kuq i avionit që sa më shumë largohet shndërrohet në një yll duke mbetur në përjetësi. Disa minuta më vonë raportohet se një avion ka pësuar katastrofë ajrore dhe ka rënë në det në gjirin e Vlorës duke shkaktuar dhe humbjen e jetëve të dy ushtarakëve nga me të mirët e Aviacionit luftarak. Shumë hipoteza e variante janë ngritur e hedhur për zbardhjen e kësaj katastrofe por asnjë nuk mund të quhet e vërtet. Por cila është e vërteta e kësaj ngjarje të rëndë. Ajo nuk dihet. Të vërtetat e tragjedive në aviacion, ato më realet, më të hidhurat, paradoksalet, të rastit apo të çdo varianti tjetër nuk ka komision apo grup ekspertësh që t`i zbardhi apo vërtetoj. Të vërtetat e tyre i marrin me vete ata që ikin, ashtu si morën me vete dhe këta dy ushtarak të vërtetën e kësaj ngjarje të hidhur. Edhe pse kanë kaluar 43 vite nga ngjarja tragjike, kujtimi i tyre ka mbetur i gjallë në kujtesën tonë, në mënyrë të veçantë në kujtesën e familjarëve, të efektivave të aviacionit e të popullit të Vlorës të cilët i nderojnë sot dy efektivët e Forcës Ajrore me titullin e lart "Qytetar Nderi". Salla e Pallatit të kulturës "Labëria" është e mbushur plotë. Znj. Etjona Hoxha, Prefekte e Vlorës dhe z. Shpëtim Gjika, Kryetar i Bashkisë u dorëzojnë pjesëtarëve të familjeve të dëshmorëve certifikatat përkatëse. Në emër të efektivave të Forcës Ajrore përshëndeti Komandanti i Forcës Ajrore gjeneralbrigade Frederik Beltoja. Të pranishmit ndoqën me interes një dokumentar mbi jetën dhe aktivitetin e dy Dëshmorëve të Atdheut Shyqëri Balla dhe Kaso Petoshati.


Nga ceremonia e organizuar në qytetin e Vlorës

# Dëshmorët e Atdheut që përkujtojmë me krenari

Dëshmori i Atdheut Shyqëri Aziz Balla ka lindur më 13.02.1931 në fshatin Orenjë-Çermenikë, Librazhd, në një familje fshatare e patriote. Arsimin fillor e ka kryer në fshatin e lindjes. Në tetor të vitit 1947 filloj studimet në Shkollën Ushtarake "Skënderbej" e më pas Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, të cilën e përfundoj me rezultate të shkëlqyera e për rrjedhojë u caktua me punë si mësimdhënës (pedagog) në këtë shkollë në lëndët ushtarake ku shërbeu në periudhën 1951-1955.

Në vitet 1955-1959 caktohet të shërbej në Komandën e Regjimentit të Aviacionit në Kuçovë, në detyrën e drejtuesit të fluturimeve pas një specializimi të bërë për këtë detyrë. Në biografin e pasur të sukseseve në detyrën e tij shënohet dhe një ngjarje nga më të veçantat e historisë së aviacionit luftarak. Më 31 dhjetor 1958 një avion i huaj (Anglez) tip C-54D "Skymaster" u kap nga avionët reaktiv të Regjimentit të Kuçovës dhe u detyrua të ulet në pistën e kësaj Baze. Shyqëriu kryente detyrën e shturmanit dhe realizoj me sukses komunikimin me pilotet e huaj dhe uljen e avionit. Presidiumi i Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë, me vendimin Nr. 2651 dt.26.04.1959, për kryerjen me sukses të kësaj detyre, i dekoroj pilotët dhe aviodrejtuesin Shyqëri Balla. Si rezultat i përkushtimit në kryerjen e detyrave për kapjen dhe shoqërimin e avionëve të huaj që shkelnin hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë vlerësohet me gradim jashtë radhe. Në vitet 1959-1960, Shyqëriu dërgohet për shkollim dhe specializim të avancuar për shturman (Aviodrejtues) në Krasnodar të B. Sovjetik. Mbas kthimi nga B. Sovjeti, në vitet 1960-1966vazhdon të shërbej në Komandën e Regjimentit të Aviacionit në Kuçovë. Në vitet 1967-1968 kreu studimet në Akademinë Ushtarake "Mehmet Shehu", të cilat i përfundoi me rezultate te shkëlqyera. Pas mbarimit të Akademisë Ushtarake emërohet shef i Shtabit të Shkollës së Aviacionit në Vlorë, ku përgatitej armata e pilotëve dhe specialistëve të ardhshëm të armës së aviacionit luftarak. Shyqëri Aziz Balla qe një kuadër i kompletuar në të gjitha drejtimet, si njeri me vlera të veçanta qytetare, moralo-etike dhe ushtarake. Për kontributet e shquara e rezultatet e larta në punë është dekoruar me urdhra e medalje të ndryshme nga Presidiumi i Kuvendit Popullor.

Dëshmori i Atdheut Kaso Salo Petroshati ka lindur më 09.07.1935 në Dukat të Vlorës në një familje të mesme fshatare me tradita patriotike e atdhetare. Arsimin fillor e shtatëvjeçar e ka kryer në qytetin e Vlorës. Në vitin 1948 shkon vullnetar në hekurudhën Durrës-Elbasan. Në vitin 1953dërgohet për studime në Shkollën Ushtarake "Skënderbej" e një vit më vonë, në 1954, dërgohet në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve "Enver Hoxha" të degën e xhenios. Në muajin qershor të vitit 1955, Kasua dërgohet në Shkollën e Lartë të Marinës Luftarake në Leningrad të B. Sovjetik, prej ku, me kërkesën e tij, dërgohet në Shkollën e lartë të Aviacionit në qytetin e Borisglebskut, të cilën do ta vazhdonte deri në maj të vitit 1959. Mbas kthimi nga B. Sovjetik, shërben në Regjimentin e Aviacionit në Kuçovë. Me krijimin e Shkollës së lartë të Aviacionit në qytetin e Vlorës, caktohet si pilot instruktor në këtë shkollë, ku dha një kontribut të madh në përgatitjen e pilotëve të rinj. Në dt. 06.05.1971, gjatë realizimit të detyrave për fluturimet natën, ngrihen në fluturim së bashku me shefin e Shtabit të Shkollës Shyqëri Aziz Balla me avionin stërvitor tip "Jak-61" në orën 20:35 dhe si rezultat i në defekti teknik pësojnë aksident ajror duke rënë në det e për rrjedhojë humbën jetën të dy së bashku tragjikisht. Kaso Salo Petroshati është dalluar për punë këmbëngulëse, sakrificë, për frymë të thellë humaniste, si njeri me vlera të veçanta qytetare, moralo-etike dhe ushtarake. Për kontributin e tij e rezultatet e larta në punë është vlerësuar nga Komanda e Aviacionit si dhe është dekoruar me urdhra e medalje të ndryshme nga Presidiumi i Kuvendit Popullor. Po me vendim të Këshillit Bashkiak, një rrugë në qytetin e Vlorës mban emrin e Dëshmorit Kaso Petroshati. Me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr 228, datë 22.04.1996 janë shpallur "Dëshmorë të Atdheut". Ata nuk ishin vetëm ushtarakë të zotë, por edhe njerëz me shpirt të pastër e të virtytshëm, besnikë ndaj popullit dhe atdheut, nderit dhe besimit ushtarak. Këto e bëjnë kujtimin e tyre të paharruar, jo vetëm për ata që i kanë njohur por edhe për çdo qytetar të vendit tonë. Dëshmorët e Atdheut të Aviacionit, me ndjenjën e lartë të përgjegjësisë në zbatimin e detyrave, me eksperiencën e madhe e të çmuar që kanë lënë pas për brezat e ardhshëm, me krenarinë që i kanë dhënë aviacionit dhe Forcave të Armatosura, janë pa diskutim një vlerë e madhe kombëtare. Ata patën një jetë të këputur në mes, por ata do të kujtohen gjithmonë dhe nga brezat që do të vijnë. Në vendin e rënies së tyre, mes dallgëve të detit nuk mund të ngrihet memorial për të përjetësuar kujtimin e tyre, por memoriali i madh për dëshmorët është ai që është ngritur në zemrat e njerëzve. Kalimtarët sa herë do të kalojnë pranë bregut të detit në Vlorë do të kthejnë kokën me respekt dhe nderim për sakrificën sublime të shqiponjave shqiptare të ajrit.



"Mësimet e Nxjerra" nga misionet "EAGLE 1-7"

# Suksesi i FS, jo sipas parimit "një person, një armë", por një armë sipas llojit të misionit

KOLONEL DRITAN DEMIRAJ*

Në varësi të misionit apo detyrës, grupeve speciale u caktohet armatim individual dhe organik. Kjo do të thotë që për një detyrë të caktuar, një special do marrë me vete apo do të përdorë një lloj arme dhe për një detyre tjetër, një lloj arme tjetër, që i përgjigjet atij misioni. Këto rregulla duhet të jenë të përcaktuara në procedurat standarde të veprimit dhe saktësohen në procesin e planëzimit të detyrës nga vetë grupet speciale, ku një nga hapat më vete është zgjedhja dhe caktimi i armatimit për detyrë. Kjo zgjedhje e armatimit bëhet edhe mbi bazën e disa faktorëve të tjerë si: rëndësia e misionit (shumica e misioneve të FS janë misione të nivelit taktik por që kanë rëndësi të nivelit strategjik) objekti mbi të cilin kryhet misioni, terreni ku do të veprohet dhe koha. Kështu psh: për të realizuar me sukses një operacion të çlirimit të pengjeve në avion, nuk mund të përdoren armë me kalibër të madh, por armë automatike HKMP5A5 ose HKUMP kalibër 9x19 mm pasi kërkohet precizion i lartë, fuqi shpuese jo shumë e madhe, ose në godinë psh: për arsye të rikoshetimit, lëndëve djegëse, sigurisë, etj; për operacione speciale që kërkojnë infiltrimin nga deti kërkohen armë të cilat kanë qëndrueshmëri ndaj kripës së detit dhe forcë shpuese të madhe nën ujë si psh: HK MP7A1, HK MP5N, HK G36CN, HK Mark 23, Beretta ARX 160A2, FN 5.7 mm, të cilat janë shumë të operueshme nën ujë dhe që mundësojnë vendosjen e të gjitha aksesoreve për të realizuar operacionet speciale në anije dhe tragete, misionet në lartësitë e mëdha në malet e Afganistanit kërkojnë armë që të dëmtojnë kundërshtarin nga distanca të mëdha, si psh: Sako 42, AW 338 Lapua, HK 416-417 me tytë të gjatë, etj; për hapjen e dyerve do të duhet të përdoret shotgani Super Bennelli, etj. Në këtë drejtim në BFS është bërë një punë e mirë por ngelet problem siç e kam theksuar dhe më lart plotësimi i TOP-it.



*Kjo do të thotë që për një detyrë të caktuar, një special do marrë me vete apo do të përdorë një lloj arme dhe për një detyre tjetër, një lloj arme tjetër, që i përgjigjet atij misioni*



### Parimi i 20% të pajisjeve rezervë për të parashikuar humbjet dhe dëmtimet

Nisur nga larmia e detyrave që kryejnë FS në mision, operacionet në kushte të vështira terreni dhe moti, shtrirja kohore e misionit, largësisë së zonës së operacionit, mund të shkaktohen defekte teknike gjatë përdorimit të pajisjeve apo dhe armatimit, ku mundësitë për riparimin e këtyre defekteve mund të jenë të limituara. Po kështu mund të ndodhin dhe humbje të pajisjeve nga vetë natyra e misionit, terrenit apo dhe shkaqeve të natyrave të ndryshme. Deri tani mbështetja logjistike e trupave në mision, duke përfshirë dhe pjesën e ndërrimit për armatimin që ata kanë në përdorim, është siguruar nga partnerët tanë, në përbërje të cilëve trupat tona kryejnë detyrat. FS tona kanë në përdorim dhe armatim që nuk njihet apo përdoret nga aleatët si në rastin e mitralozit 12.7 mm "Dishka", të cilave po t'u shtojmë dhe mundësitë e pakta të mbështetjes logjistike strategjike që kemi aktualisht për forcat gjatë kryerjes së misionit, lind si domosdoshmëri zbatimi i parimit të krijimit të vazhdimësisë së furnizimit duke planëzuar dhe i pajisur që në nisje forcat me 20% të pajisjeve si rezervë përdorimi. Për sa i përket pjesës tjetër të llojit të armatimit që përdorim atje në dislokim, është zbatuar parimi i rezervës për armët automatike dhe pistoleta. Problem shumë i madh ngelet akoma mos plotësimi i trupave në mision me mitralozin e lehtë dhe të rëndë të kalibrave të NATO-s (HK MG4 5.56mm dhe FN H 7.62 mm) pasi mos kompletimi me to, dëmton seriozisht dhe në një shkallë jo të vogël fuqinë e zjarrit të grupit në detyrë dhe jetën e tyre. Një problem tjetër dhe aspak më i parëndësishëm është dhe mos kompletimi i armëve me dylbi nate. Asnjë nga armët tona në mision nuk ka dylbi nate (përveç snajperave), bile dhe dylbitë EOT-c që kemi në përdorim në detyrë, nuk funksionojnë siç duhet, pasi kushtet në të cilat ato kanë qënë magazinuar nga Brigada Logjistike, nuk kanë qënë të mira dhe drita e tyre nuk funksionon ditën, gjë që e vendos operatorin e FS në rrezik të drejtpërdrejtë në detyrë. Asnjë nga armët nuk është e pajisur me silenciator gjë e cila e bën të pamundur elementin surprizë, një nga elementet më të rëndësishme të cilat mundësojnë sukses gjatë kryerjes së operacioneve speciale. Po ashtu armët automatike dhe pistoletat nuk janë të pajisura me elektrikë taktikë apo me infrared, në një kohë që shumica e detyrave që ata kryejnë në Afganistan realizohet natën dhe në vende ku kontrollohen shpella në kushtet e errësirës së plotë, pajisje të cilat mos kompletimi me to e rrezikon së tepërmi jetën e tyre dhe realizimin me sukses të detyrës. Në këtë drejtim mund të veçojmë si shembull të mirë armatimin Snajper që BFS ka në përdorim, si: Sako 22-42, Sako MI 10, HK 417, HK PSG-1, të cilat janë blerë të gjitha me silenciatorë, distancë matës, erë matës, dylbi shumë të fuqishme vëzhguesi, kompjuter për përcaktimin e të dhënave të ndryshme, municion shumë të saktë, kostume maskimi për çdo lloj terreni dhe së fundmi në Nëntor 2013 dhe me dylbi nate të sofistikuara që i plotësojnë 100% kërkesat operacionale. Stërvitja e trupave me armatim dhe pajisje në përdorim, gjatë fazës së përgatitjes para dislokimit Nga eksperienca e kryerjes së misioneve të deritanishme të kontingjenteve të FA në përbërje të NATO-s, dhe veçanërisht të misioneve "Eagle", del si element i domosdoshëm përgatitja e trupave me armatimin dhe pajisjet që ata do të përdorin në mision, që në fazën përgatitore para dislokimit, pasi dërgimi dhe realizimi i misionit do të bëhet me këto pajisje dhe armatim. Gjatë realizimit të programit të fazës përgatitore për në mision, është e domosdoshme përgatitja për qitje taktike e personelit me armatimin personal e special që do të ketë me vete në mision, pasi gjatë kësaj faze bëhet jo vetëm përshtatja dhe njohja e këtij armatimi, por edhe veçoritë dhe karakteristikat teknike të përdorimit të tyre duke rritur shkallën e besimit të efektivave me pajisjet dhe armatimin që ato kanë në përdorim. Në këtë kuadër gjykoj se sasia e municionit që miratohet nga eprorët tanë në KFT dhe SHP është krejtësisht e pamjaftueshme, pasi sipas rregullit të NATO-s për stërvitjen paradislokuese secili nga operatorët duhet së paku të realizojë minimalisht 1500 fishekë qitje me automatikun, 500 fishekë me pistoletën dhe 300 fishekë qitje me snajperin e tij personal.

### Organizimi i ndërlidhjes në mision të kontingjenteve "Eagle"

Operacionet speciale shpesh herë kryhen në distanca të mëdha nga bazat e tyre, gjë që kërkojnë sisteme të sofistikuara dhe të sigurta të komunikimit dhe mjete për infiltrimin, mbështetjen dhe eksfiltrimin (daljen) për t'u kthyer nga zonat e ndjeshme të armikut me rëndësi të madhe politike dhe ushtarake. Masat për funksionimin normal të komunikimit kanë rëndësi të jashtëzakonshme sidomos gjatë zhvillimit të operacioneve luftarake të përbashkëta. Komunikimi me radio, si edhe nëpërmjet rrjeteve të tjera të komunikimit ushtarak, duhet të jetë mënyra kryesore gjatë zhvillimit të operacioneve për komandim-kontrollin (C2). Nisur nga natyra e misionit, detyrat që kanë realizuar kontingjentet "Eagle" strukturat e ndërlidhjes si J6 në SHP, të G6 në FT, ato të S6 në BFS, u angazhuan për mbështetjen e konjektimin me sisteme ndërlidhje në mënyrë të vazhdueshme e të pandërprerë midis QBO-s/SHPFA/MM, qendrën e ndërlidhjes së operacioneve të BFS dhe Komandantit të FS pjesëmarrëse në mision, në mënyrat e komunikimit, foni dhe transmetim të dhënash në mënyrë të klasifikuar, pasi ka qenë hera e parë që është vendosur komunikimi i sigurt me çelësa kriptimi. Duhet theksuar se ky lloj komunikimi nuk ka asnjë kosto ekonomike satelitore dhe me anë të tij mund të transmetosh në çdo kohë dhe në çdo orë. Por nga ana tjetër të gjitha pajisjet e ndërlidhjes që kishim ne në përdorim, nuk na mundësonin kriptimin, e cila mundësohej nga kolegët amerikanë. Mendoj që ka ardhur koha që të mendohet për blerjen e këtyre çelësave të cilat mundësojnë sigurinë e komunikimit në operacion. Për të rritur shkallën e ndërveprueshmërisë gjatë kryerjes së veprimeve taktike brenda grupit dhe realizimin me sukses të detyrave speciale si: goditje objekti, zbulim special, kontroll banesash, kontrolle në shpella etj, kontingjenti ynë që ishte në mision, u pajis me radio Harris RF-7800, të cilat janë shumë moderne dhe bashkëkohore, kishin kufje, të pajisura me GPS për të gjetur vendndodhjen e saktë të çdo operatori në çdo moment, kanë mikrofon, si dhe u kompletuan dhe me "Push To Talk" (PTT), e cila bën të mundur komunikimin pa shtypur ganxhën e radios, por me anë të wirelesit që montohet tek arma ose mund të mbahet në çdo lloj pozicioni pa penguar veprimet që mund të bëhen me armën. Fatkeqësisht këto radio dhe sot e kësaj dite nuk i përdorin dot, pasi është e pamundur përdorimi i tyre nga modeli i vjetër i helmetave të cilat ne kemi në përdorim. Prej 3 vitesh kam kërkuar personalisht blerjen e 50 helmetave të reja me prerje që mundësojnë vendosjen dhe përdorimin e këtyre radiove, kamerave dhe të elektrikëve.

*Shef i Qendrës së Simulimit

# Apokalipsi "drone"...

BONIN TOPTANI

Bota ka parë shumë luftëra e ndër të tjera pa edhe holokaustin njerëzor të Luftës II Botërore që i solli aq shumë ndryshime mbarë njerëzimit. Një nga shpresat e mëdha të saj ishte se bota nuk do të mendonte më për të në të ardhmen. Por vitet provuan të kundërtën! Jo vetëm që u "harruan" premtimet e mëdha të pasluftës, por shpejt blloqet ushtarake, të perëndimit të lirë e lindjes sovjetike, ndërtuan edhe armët më të frikshme për mbarë njerëzimin, armët atomike. Gjithsesi prova e dhjetëvjeçarëve tregoi se qeveritë dhe politika e atyre viteve u treguan të "përgjegjshme" pasi nuk rezultuan përplasje të natyrës ushtarake bërthamore, përveç atyre rasteve që për interesa mbase shumë të mëdha popuj të vegjël tentuan të shkatërrojnë njëri-tjetrin. Në epokën post moderne, pra më mbarimin e Luftës së Ftohtë, njerëzimi përsëri shpresoi se në këtë kohë të re, koha e lëvizjes së lirë dhe e teknologjisë në shërbim të të gjithëve, se nuk do të mendohet më për luftërat e do të tentohet të arrihen lartësi në jetën tonë të pa mendueshme më parë. Por jo, si përherë egoizmi njerëzor është i pandryshueshëm dhe luftërat e ndodhura pas viteve '90 demonstruan se pak ka ndryshuar. Por ajo që ka ndryshuar në të vërtetë janë idetë e reja, nevojat e sotme dhe përparimi tejskajshëm teknologjik. Kjo ka sjellë ndryshime shumë të rëndësishme edhe në fushën ushtarake. Sot nuk mendohet më si më parë për pozicionimin e qindra anijeve lufte për të kontrolluar një zonë të caktuar, me njerëzit e mjetet që kjo do të kërkonte, por më tepër dërgimi i një aeroplanmbajtëse të vetme, por me 100 F 16 brenda, ose të një nëndetëseje atomike të thellësive të mëdha e tejmbushur me raketa. Zhvillimi më i madh i kohës së sotme vjen në fushën ë aviacionit, me arritjet e teknologjisë Stealth, që u demonstruan më së miri gjatë goditjeve ushtarake ndaj diktaturave në Irak e gjetkë. Kjo teknologji vjen çdo ditë e duke përparuar e sot jemi dëshmitarë edhe të avionëve pa pilotë, dronët, të cilët përtej vlerave që sjellin, meqë pretendon të shpëtojë jetën e shumë njerëzve të aviacionit, bie edhe të renë që makinat rast pas rasti do të vijojnë të zëvendësojnë njerëzit. E kjo nuk mund të na lejë pa menduar edhe për serinë e filmave të mirënjohur hollivudian "Terminator". Dronët janë tashmë hapi i fundit i shkencës bashkëkohore, të lehtë e të vegjël, pa shumë shpenzime, por që qetësisht e pa rrezikuar më jetën e pilotit, nëse hyn në një hapësirë ajrore të huaj i "pa ftuar". Ai me sa duket do të jetë në dhjetëvjeçarët e ardhshëm kufiri teknologjik e shkencor për arritjet e garuesve të mëdhenj botërore në teknologjitë ushtarake, "beteja" e ardhshme për t'u fituar nga lojtarët e mëdhenj gjeopolitikë. Kështu, i tërhequr nga kjo teknologji më ra rasti të lexoj revistën italiane të gjeopolitikës "LIMES", të fundit të vitit 2013 ku në njërin nga kapitujt mbi parashikimet e 2014 flitet edhe për këto makina të së ardhmes, dronët. Dronët janë robotë me aftësi të limituara vendimmarrëse që mund të komandohet në distancë. Ata janë jo vetëm avionë fluturues, ndonëse në imagjinatën e zakonshme ato fluturojnë, por ka edhe tokësore e ujorë. Termi "drone" vjen nga anglishtja, ku "drone", quhet mashkulli i bletës. Është përdorur ky emër për dronët elektrikë, për shkak të zhurmës tipike si të atyre natyral.




**1.**

Avioni pa pilot, droni, është arma e dhjetëvjeçarit, shumë e dashur për Obamën. Robotët fluturues i pëlqejnë amerikanëve pasi reduktojnë rreziqet e janë të padukshëm për publikun. Por efektet i kanë të limituara: nuk shkatërrohet "kosherja" e terrorizmit duke goditur "bletë" të vetme. Nëse do të ambientohej filmi "Apokalypse now" në ditët e sotme, në vend të helikopterëve në skenën kryesore të kryeveprës së Francis Ford Coppola do të përdoreshin dronët. E do të bënte që koloneli Kilgoroe të thoshte: "adhuroj zhurmën e "Predator-it" (dronit) në mëngjes! Droni ka qenë arma e dhjetëvjeçarit për SHBA, arma simbol amerikane, në periudhën kur superfuqia e vetme ndihet absolute. E legjitimuar për misione humanitare e dehje teknologjike për të hapur fusha betejash në katër cepat e planetit. Epokë e cila përgjithësisht mbaron në 2006 kur Bush Jr do të kthente drejtimin e aksionit që kish shpërhapur perandorinë. Megjithatë, ajo do të shtyhej deri në vitet 2011 e 2012, pika më e lartë e fushatës së dronëve kundër Al Qaida-s, në teatro ku fuqia ushtarake amerikane nuk kishte asnjë rezistencë. Në erën e sotme, avioni pa pilot përfaqëson nevojën amerikane të së zhvilluarit të luftërave pa rreziqe, duke minimizuar humbjet e veta për të mos gërryer më tej konsensusin e brishtë popullor në shtëpi. Droni heq fizikisht ushtarin nga fusha, duke e hequr atë nga ndeshja me kundërshtarë të dobët por efikas në përdorimin e armëve dhe taktikave kryengritëse, si bomba artizanale ose autobomba. Në këtë kuptim roboti ka qenë përgjigje ndaj atentatorëve vetëvrasës. Në këtë dhjetëvjeçar të gjatë, droni ka shtënë për herë të parë në Afganistan pak orë nga mësymja e viti 2001 dhe, në fillim të 2013, ishte përgjegjës për rreth një të katërtën e bombardimeve në Kabul e rrethina. Ka shërbyer në Irak e Libi duke rrëzuar rreth 145 objektivë. Ka lejuar shpërthimin e konflikteve klandestine kundër qaidistëve në Pakistan, Jemen e Somali, vende jo formalisht në luftë më SHBA, duke bërë më tepër se 3000 viktima në më shumë se 450 sulme. Buxheti i dedikuar dronëve është rritur nga 284 milion dollarë në 2000, në 3.8 miliardë në 2013, duke përbërë një flotë që nëse në 2002 kishte 167 ekzemplarë, sot ka më tepër se 8 mijë. Lufta e dronëve në të cilën kemi asistuar është vetëm një embrion i së ardhmes së këtij instrumenti, që për treg e mundësi, i përafrohet armëve me energji direkt, kibernetikës e teknologjive të destinuara të kenë një impakt të fortë në raportet e fuqisë midis aktorëve gjeopolitikë. Gjithsesi, zhvillimi i dronëve ka edhe të paktën katër probleme e pyetje:

a) efikasiteti kundër kryengritjeve e terroristëve;

b) impakti mbi trupat ushtarake;

c) dilemat etike e strategjike të autonomisë dhe,

d) përhapja.

Për t'i kuptuar drejt ato, duhet të adoptohet perspektiva amerikane, si monopolistë, nëse jo të armës të paktën të doktrinës së përdorimit të saj.

**2.**

I vetëm, droni nuk çrrënjos qëllimet që ushqejnë konfliktet ku ai ndërhyn. Nuk mund t'a bëjë: mbetet gjithnjë një instrument taktik, jo strategjik. Megjithatë në këtë fushë SHBA kanë ngritur një bastion kundër terrorizmit qaidist, i mbështetur vetëm nga inteligjenca e ndërhyrjet e forcave speciale. Duke i besuar kësaj arme, Uashingtoni e ka bërë të vazhdueshme luftën kudër Al-Qaidës, të paktën për dy motive:

I pari, impakti i një rakete të ardhur nga qielli herë pas herë, është i limituar. SHBA në fakt janë duke zëvendësuar të "këqijtë" e parë me ata që u vijnë nga pas. Në metaforën e shkëlqyer të ish-analistët të CIA-s Bruce Riedel theksohet koncepti "të shkatërrosh kosheren e bletëve duke goditur bletë të vetme, mund të shkatërrosh të gjitha bletët, por jo kosheren". Në të vërtetë droni duket se gjeneron efekte pozitive, por të përcaktuara gjeografikisht: në zonat tribale pakistane, vërehet korrelacion midis bombardimeve e uljes së frekuencës së aktiviteteve të terroristëve në rreze prej 125 km.

*Dronët janë robotë me aftësi të limituara vendimmarrëse që mund të komandohet në distancë. Ata janë jo vetëm avionë fluturues, ndonëse në imagjinatën e zakonshme ato fluturojnë, por ka edhe tokësorë e ujorë. Termi "drone" vjen nga anglishtja, ku "drone", quhet mashkulli i bletës. Është përdorur ky emër për dronët elektrikë, për shkak të zhurmës tipike si të atyre natyral.*



E dyta, abuzimi i dronëve gjeneron më tepër armiq nga sa eliminon. Uashingtoni nuk përqendrohet vetëm mbi liderët, por edhe mbi "ushtarët" e terrorizmit. Megjithatë militantët e niveleve të ulëta shpesh nuk mbajnë me Ak-47-ën për të bërë atentatet në Amerikë, por për motive ekonomike ose sepse Al-Qaida i ndihmon në kryengritje lokale. Për më tepër, duke zgjeruar numrin e objektivëve shtohet edhe rreziku i dëmeve anësore si "vdekje civile, invalidë të përhershëm, prona të shkatërruara. Posaçërisht nëse veprohet me teknika si signature strikes (sulme të shënuara), në të cilat goditet një shënjestër jo pse i përket një kundërshtari, por se nga qëndrimi parashikohet e tillë. Kjo mund të gjenerojë hakmarrje, të thellojë varfërinë e familjeve të përfshira, të furnizojë "bletë" apo t'i japë krahë propagandës së armikut. Duke shtuar radhët e xhihadistëve! Që një nga problemet e dronëve është magnituda e demonstron fakti: atje ku robotët godasin me më pak frekuencë, njerëzit i shohin robotët si instrument për t'u liruar nga prezenca e militantëve xhihadistë. Aparati i sigurisë amerikane duket se e mbështet këtë mënyrë veprimi, pak largpamëse. Duke e goditur pareshtur Al Qaidën reduktohen mundësitë që një atentat i mundshëm të shpëtojë nga duart dhe kontrolli i antiterrorizmit. Për më tepër, nuk është imperative të investohen kaq shumë dollarë e diplomaci për të tentuar çrrënjosjen e antiamerikanizmit, njëra nga arsyet e xhihadizmit në botë. Të tjera duket se janë prioritetet gjeopolitike të administratës, edhe kështu jo shumë e prirur drejt politikës së jashtme. Së fundi, nuk është edhe ndonjë dëm i madh të armiqësosh regjime si ai Jemenit, shumë i dobët për të siguruar një aleancë të vërtetë, ose atë Pakistan, shumë i pabesueshëm, se edhe nën influencë kineze. Kush do të dojë të







përdorë dronët duket të ketë parasysh edhe këto mësime. Sigurisht, vështirë që dikush tjetër të disponojë një rrjetë e satelitësh globalë si SHBA për të ngritur një dron nga Xhibuti, ta pilotojë nga Nevada, për të goditur një objektiv armik në Jemen. Megjithatë roboti mund të përdoret nga aktorë në marrëdhënie me terroristë ose me kryengritës lokalë: si Izraeli rreth "kopshtit të shtëpisë"; Turqia me kurdët, Kina, me Tibetin e Xingiang-un. Manuali amerikan mund t'u duhet të gjithëve.

**3.**

Pyetja e tretë rreth zhvillimit të dronëve i referohet nevojës së administrimit të impaktit të luftës nga distanca për trupat ushtarake. Roboti sjell revolucion: në procesin mijëravjeçar të ndarjes së ushtarakut nga fusha e luftës - nga katapulta e raketave balistike bërthamore ndërkontinentale - nuk ishte shpikur asnjëherë një armë që të anulonte reciprocitetin. Martin van Creveld thekson: "Lufta nuk fillon kur dikush vret dikë tjetër, por fillon kur dikush rrezikon të vritet nga një tjetër". Ndërsa droni e ndryshon komplet domethënien e shprehjes "të shkuarit në luftë". Piloti vetë është plotësisht në luftë, shikon tërësisht ato që ndodhin në fushën e luftës, në mos edhe më tepër. Vetëm se nuk rrezikon jetën e tij. Efektet mbi personelin ushtarak të kësaj përvoje të re janë shprehur ndërmjet ushtarakëve amerikanë e mund të përcaktohen në ndarje. Së pari, impakti psikik. Roboti e lë trupin të sigurt, por jo sytë e mendjen. Një studim mbi pilotët që kanë shërbyer në Afganistan midis viteve 2003 - 2011 ka vërejtur që frekuenca e shqetësimeve mendore për operatorët e dronëve është më e lartë se ndër ata të avionëve konvencionalë. Edhe pilotë ekspertë e të shëndetshëm kanë pranuar që kalojnë një jetë skizofrene. Impakti amplifikohet nga fakti se rekrutimet në Forcën Ajrore janë ulur në gjysmën e tyre, për arsye të kërkesës së madhe për dronë, gjë që ka ulur edhe moshën mesatare të ekuipazheve. Së dyti, virtualiteti. Nëse ia dilet të qëndrohet larg dhunës e rrezikut, krijohet edhe rreziku i kundërt, ai i përfshirjes së tepërt: bërja e luftës sterile, pra të shtohet dëshira e përdorimit të armës, ose të mos merret më seriozisht ajo. Ka oficerë amerikanë që dëshmojnë se mezi ia dalin të ruajnë përqendrimin ndër ekuipazhe. Edhe se pse kur shkohet në luftë, e gjithë jeta e njeriut është rreth saj. Duke luftuar nga shtëpia apo jo: në mëngjes shkatërron xhihadistë në Pakistan e në mbrëmje shoqëron fëmijët në një ndeshje futbolli. Si solucion i mirë mund të rezultojë të rreshtohen ekuipazhet sa më afër zonës së operacioneve. Alternativa është të çosh ushtarët në pension. Si futbollistët. Së treti, kohezioni i forcave ushtarake. Ekspozimi i ndryshëm i tyre ndaj rrezikut, të ekuipazheve të dronëve dhe të njësive në fushën e betejës, vë në rrezik jo vetëm mirëkuptimin reciprok të tyre por edhe bindjen ndaj vlerave dhe parimeve të përbashkëta. Peter Singer, autor i vëllimit mbi robotët thotë Wired for war komenton: "Nëse forcat e armatosura janë gjithnjë të ndara midis atyre qe rrijnë prapa një kompiuteri e atyre që venë në rrezik jetën e tyre, ndërmjet palëve mund të lindin pritshmëri të ndryshme. Njëra palë do të mbështetet tek vlerat e forcës fizike, të guximit, duke u frymëzuar nga protagonistët e betejave të Normandisë, pala tjetër do i shohë këto vlera të huaja për përvojën e vet ushtarake ose deri edhe jo të nevojshme në erën e re teknologjike". Si të ruhet atëherë një ethos i përbashkët?




**4.**

Dilema e katërt është rreth rinovimit në studimet e Forcave të Armatosura të gjysmës së botës: autonomia e dronëve, që për herë të parë në histori mund t'i heqë nga duart njeriut monopolin e luftës. Por nuk jemi ende në këtë pikë: për tani, mjetet pa pilot, perfektë në hapësirat e ajrore të pakontestuara, janë aq të pasaktë sa nuk do të mbijetonin edhe artilerive më të vjetra kundërajrore. Shkojnë mirë për në Afganistan, në Siri kanë jo pak vështirësi, le më pastaj t'i mendosh kundër Kinës. Gjithsesi, përmirësimet në inteligjencën artificiale të lenë të besosh parashikimin në disa taktika të së ardhmes së afërt: grupe robotësh të dimensioneve të mesme e të vogla për të dëmtuar linjat armike, dronë lufte përkrah avionëve gjuajtës; sisteme lokalizimi e shënjestrimi të personave. Dyshimi mbetet: sa e çfarë tip force t'u delegohet makinave? Si të garantohet një supervizionim i njeriut duke krijuar njëkohësisht edhe sisteme autonome? Një përgjigje e parë vjen nga direktiva e Pentagonit e nëntorit 2012, dokumenti cili i jep dritë jeshile zhvillimit të armëve vdekjeprurëse autonome, duke ngarkuar Zëvendëssekretarët e Mbrojtjes e Shefin e Shtabeve të Bashkuara të autorizojnë përdorimin e tyre, me disa parakushte. Të cilat ama nuk janë fort të ndryshme nga armët e tjera: zhvillimet teknike e taktike; teste rigoroze për makinat e softuerët, mekanizmat për t'u lejuar operatorëve të çaktivizojnë autonominë e procedurat për të minimizuar rreziqet e goditjes së shënjestrave të padëshiruara. Tjetër paqartësi e direktivës: sistemet autonome duhet të jetë të projektuar për t'u lejuar komandantit e operatorëve të ushtrojnë nivelet e duhura të gjykimit njerëzor". Në bazë të kësaj formule, nuk është e thënë që një njeri të jetë gjithnjë përgjegjësi i vendimit me vrarë. Por kjo është edhe çështja kryesore e ndërhyrjes së robotëve në luftë. Duhet siguria që do të jetë gjithnjë një qenie njerëzore me detyrën për të dalluar një civil nga një armik ose objektiv që e vlen të shkatërrohet nga një tjetër për t'u kursyer, për llogari politike apo rrethanash. Mund t'i përcaktosh dronëve të godasin objektiva të "pajetë", duke lënë mënjanë njerëzit ose të kërkosh autorizimin përpara të shtënave (po edhe kështu nuk mund të reduktohet rreziku i goditjes të atij që sillet si armik, por që në të vërtetë nuk është); mund edhe të delegohet në nivel taktik vendimi për autonominë. Së paku, në periudhën e parë të përdorimi të sistemeve autonome, autorizimi për t'i përdorur në mënyrë vdekjeprurëse ato duhet të nisë nga nivelet më të larta të zinxhirit të komandimit. Sfidë e vështirë: një arkitekturë e tillë është e parashikuar për armët bërthamore, gjithsesi të paramenduara për raste ekstreme, jo për t'u përdorur për surrogatë të njeriut në luftëra jo apokaliptike. Kështu, loja mbi tavolinë është mbijetesa e vetë konceptit të përgjegjësisë. Kujt t'i vihet faji për faj një droni që fillon të shtijë pa motiv kundër civilëve të pambrojtur? Operatorit njerëzor që e kuptoi me vonesë që njëri nga mjetet fluturues është çmendur? Komandantit të asaj njësie që ka autorizuar përdorimin e asaj makine? Pastaj, çfarë faji të caktohet? Krim lufte apo defekt i prodhimit?

**5.**

Shpërhapja, proliferation, është dimensioni i fundit problematik i zhvillimit të robotëve. Gara për dronët është në zhvillim e sipër: 87 vende po zhvillojnë programe ushtarake të avionëve pa pilotë. Italia e Franca duan të armatosin Reaper-ët e tyre amerikanë. Prototipe dronësh luftimi janë në studim në Evropë (dy projekte që përfshijnë britanikë, francezë, suedezë e italianë), Rusi e Iran. Në Azinë lindore, Vietnami, Korea e Jugut, Indonezia e Tajvani kanë filluar të investojnë në kërkime, ndërsa Japonia sapo ka marrë nga SHBA dronët e kontrollit Global Howk.

Në krye të grupit është Kina. Në 2011 mendohet të ketë pasur rreth 280 robotë fluturues. Ndonëse programet e dronëve kanë mbi gjysmë shekulli jetë, vetëm së fundi Pekini ka përshpejtuar. Edhe në saje të progresit të beidou, versioni mandarin i GPS-it, por mbi të gjitha në sajë të një fushate intensive spiunazhi industrial, i drejtuar nga hacker-ët shtetërorë, duke nxjerrë në dritë Yi long, Xiang long e Lijian, përsëritje të homologëve amerikanë. Brenda 2015 Kina parashikon të ndërtojë 11 baza dronësh përgjatë bregdetit të vet. Ndërkohë të hyjë edhe në tregun botëror, duke i shitur ato, si përherë, prodhime disa milionë dollarë më lirë se konkurrenca. Pentagoni i lexon këto zhvillime në kontekstin e garës me Kinën për supremacinë në detet që e rrethojnë të. Krijimi i një rrjeti rojesh në Paqësor do të ulte avantazhin informatik amerikan në ato ujëra, për më tepër strategët parashikojnë edhe hyrjen e dronëve në misionet e lëshimit të raketave kundër-anije kundër bazave ose anijeve amerikane me rreze 3000 km distancë nga brigjet kineze, që duhet ët përbëjë bërthamën e planifikimit ushtarak kinez. Përhapja robotike ka edhe një impakt në dinamikat e përshkallëzimit të përplasjeve midis shteteve. Shembulli kinez është i dobishëm, në 9 shtatorin e kaluar, Pekini "festoi" përvjetorin e blerjes së ishujve të shumë diskutuar Senkaku nga Japonia duke dërguar jo si përherë avionët ushtarakë, por një dron. Mund edhe të mendohet se ky veprim ul tensionin: nuk kishte pilot në bord që të rrezikonte jetën ose zënien rob. Por jo për të njëjtin motiv. Largimi i kërcënimit të humbjes së një njeriu sposton përballjen në një shkallë të mëtejshme: "mund të të provokojmë pa rreziqe". Ulja e rrezikshmërisë të misionit mund të çojë provokuesin të tentojë më tepër e më shpesh. Por droni, i administruar nga forca jo shumë eksperte, nuk është një makinë e besueshme. Çfarë do të ndodhte nëse një nga këto mjete përplasej në tokë? Shteti që e ka dërguar do të merrte përsipër përgjegjësinë? E nëse vendi që e sheh se po i afrohet vendos ta rrëzojë, siç ka premtuar të bëjë Japonia, si do të reagojë shteti provokues? E nëse në mes ndërhyn edhe një nga dronët e shumë të pozicionuar në ato ujëra? Pyetje të cilave nivelet e larta drejtuese të forcave të armatosura të interesuara nuk u kanë dhënë ende përgjigje të pranueshme.

**6.**

Një pyetje e fundit: Përse Uashingtoni nuk përpunon një doktrinë publike për përdorimin e dronëve? Amerikanët kanë edhe mundësinë e madhe të përpunojnë rregullat e përdorimit të këtyre makinave të së ardhmes, por dritarja kohore hollohet gjithnjë më tepër. Përtej zhvillimit të këtyre gjërave në favor të tyre, në kohën e botës një polare, kanë edhe të tjera motive. Vetë arkitektura e krijuar nga administratat amerikane nuk është shumë transparente. E megjithatë aparati i sigurisë amerikane nuk duket i gatshëm të lidhë duart me një teknologji që fleksibilitetin e ka kthyer në mburrje e që ka ende shumë potencialitet të pashprehur. Gjithashtu nuk është momenti më i mirë për ta bërë: ndër faktorët që shtyjnë një qeveri të lëshojë pe presioneve ndërkombëtare për të zhvilluar norma për përdorimin e një arme, është edhe shtytja nga garuesit. Vlen gjithnjë shembulli i realizimit të bombës sovjetike. Përveç rastit të progresive të shpejta të rivalëve të mëdhenj gjeopolitike, tejkalimi i Amerikës nga të tjerët nuk është i afërt.

**(Përshtatur në shqip nga Revista Limes – 11, 2013, autor Federico Petroni).**

# Brigada e trimërisë që çliroi ishullin e Sazanit

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ
HISTORIAN USHTARAK

## *70 vjetori i formimit të Br. XII S të UNÇSH*



Fillimisht po bëj një shpjegim në lidhje me Brigadat Sulmuese (Br.S), që vepruan gjatë LANÇ-it të popullit shqiptar. Brigada sulmuese ishte një njësi luftarake operative, e cila drejtohej nga Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH. Brigada krijohej me luftëtarë të zgjedhur e me përvojë luftarake nga krahina të vendit ose të qarkut. Sipas porosive të Shtabit të Përgjithshëm, luftëtarët duhej të ishin anëtarë të çetave partizane dhe territoriale, të vendosur për Luftën Nacionalçlirimtare, luftëtarë të palodhur dhe trima, të kishin marrë pjesë në aksione dhe të ishin të bindur e të disiplinuar. Sipas karakterit e përpjesëtimeve të LANÇ-it, të mundësive materialo-teknike, të terrenit, të mundësive për përdorimin luftarak e për drejtim, Shtabi i Përgjithshëm si formacionin (njësi) më të përshtatshme për organizimin e UNÇSH-së dhe shndërrimin shkallëzor të saj në ushtri të rregullt, zgjodhi Brigadën Sulmuese. Brigada, si rregull, përbëhej nga 3-4 batalione, por ndonjëherë ajo kishte edhe 5 batalione. Në fillim brigadat kishin rreth 400 - 600 luftëtarë, por me vonë ky numër arriti në rreth 800 -1000. Batalioni, si rregull, përbëhej nga 3 kompani me rreth 150 - 250 luftëtarë dhe kompania përbëhej prej 3 -4 toga (skuadra) me rreth 50 - 70 luftëtarë. Forcën sulmuese të brigadës e përbënin luftëtarët të pajisur me pushkë, automatikë dhe me mitraloza të lehtë e të rëndë të modeleve të ndryshme. Në çdo skuadër kishte një mitraloz të lehtë dhe në kompani një mitraloz të rëndë. Në përbërje të brigadave sulmuese ishin, zakonisht, nënreparte artilerie të pajisura me mortaja, pushkë kundërtanke ose topa malorë dhe nënreparte të vogla zbulimi, ndërlidhjeje e prapavije. Brigada sulmuesi ishte formacioni më i madh në Fazën e Dytë të luftës, e cila kishte forcë goditëse dhe mëvetësi veprimi. Ajo, ishte e pajisur kryesisht me forca këmbësore dhe me një sasi të kufizuara artilerie të transportueshme me krahë e me kafshë, që të ishin të lehta, e manovrueshme dhe t'i përshtatej terrenit malor. Këto cilësi të organizimit, si dhe gjendja moralo-politike e aftësitë e luftëtarëve, i jepnin brigadës mundësi të plotësonte detyra të rëndësishme luftarake edhe pse vepronte me taktikën e luftës partizane. Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së, orientonte se "Formimi i brigadave, duhet të jetë preokupacioni më i madh në çështjen ushtarake… Brigada është formacioni i vërtetë i Ushtrisë, formacion që do të thëthijë pak nga pak gjithë elementët e vendosur të çetave ose të batalioneve sulmuese për me mbërritur kësisoj në një ushtri të vërtetë dhe me shpirt luftarak…".

Më 20 maj 1944, në fshatin Sukë të Përmetit, mbi bazën e kuadrove dhe partizanëve që erdhën nga radhët e Grupeve të Kurveleshit, të Vlorës, të Mallakastrës dhe të Konispolit të Zonës së Parë Operative, u formua Brigada XII Sulmuese (Br. XII S). Forcat i organizoi në katër batalione me një efektiv të përgjithshëm prej rreth 670 luftëtarësh. Në komandën e brigadës u emërua Rifat Bajrami komandant dhe Mehmet Jaho, zëvendëskomandant; Qemal Klosi komisar dhe Vasil Nathanalili zëvendëskomisar. Në seksionin politik u caktuan Veiz Gjeberao, Veiz Pipa dhe Vangjelo Sotiradhi. Veprimet luftarake i zhvilloi në krahinën e Dishnicës të Përmetit, në Kurvelesh, gjatë bregut të detit Jon, në Vlorë dhe në zonën e Peqinit. Në kohën e formimit të saj, pushtuesit nazistë, kishin kohë që po organizoheshin për një operacion të ri. Ndërsa LANÇ-i, po punonte për organizimin e një kongresi. Armiku dhe reaksioni po punonin për të penguar zhvillimin e këtij kongresi. Br. XII S mori për detyrë që në bashkëveprim me Br. VII S të mbronte zonën e Përmetit nga ana e Beratit. Fillimisht brigade qëndroi si rezervë e Shtabit të Përgjithshëm. Më 2 qershor 1944, Br. XII S mori urdhrin për të hyrë menjëherë në luftime në zonën e Beratit në bashkëveprim me Br. VII S. Partizanët e brigadës luftuan kundër një armiku, i cili ishte i madh në numër, i pajisur me së miri me teknikë luftarake etj. Por, partizanët e brigadës kishin një avantazh sepse e njihnin mirë terrenin dhe kishin përvojë të gjatë në luftime. Trupat pushtuese gjermane kishin filluar në këtë kohë Operacionin e Dytë më të madh kundër UNÇSH, dhe drejtimi kryesor i tyre ishte qyteti i Përmetit. Br. XII S së bashku me Br. VII S, zhvilluan luftime të përgjakshme prej 3-9 qershor 1944 në Therepel, në Vokopolë, në Qafë të Shkozës, në Rehovë, në Qafën e Kiçokut e në Arrëz të Beratit, për mbrojtjen e drejtimit Berat-Këlcyrë. Nga goditjet e fuqishme të partizanëve të brigadës, sulmi i furishëm i nazistëve u thye. Edhe në sulmet e tjera që ndërmorën nazistët me forca dhe teknikë të shumtë, forcat partizane i përballuan me sukses. Pas luftimesh të ashpra, brigade u tërhoq, kaloi lumin Vjosa dhe u përqendruar në Kurvelesh. Aty, ajo zhvilloi luftime të ashpra në grykën e Bënçës e të Salarisë, në Qafën e Kreshtës dhe Zhurin e Kuçit nga 11-23 qershor 1944. Armiku kishte filluar Operacionin e Qershorit të vitit 1944. Br. XII S në bashkëveprim me Br. VI S, u rrethuan nga forca të shumta gjermane. Më tepër se njëzetë ditë luftime në rrethim, në kushte të vështira, me mungesë në municione dhe ushqime, me luftime të pandërprera, Br. XII S, duke njohur terrenin dhe në bashkëveprim me batalionet territoriale të zonës, i dhanë armikut goditje të fuqishme, i shkaktuan humbje dhe dolën nga rrethimi. Në një orvatje që bënë komandot angleze më 28 korrik 1944 për të çliruar Himarën, pësuan disfatë. Komandot angleze shpëtuan nga asgjësimi prej forcave të Br. XII S, në bashkëveprim me forcat territoriale, të cilat i sulmuan gjermanët nga toka dhe çliruan Himarën. Shtabi i Përgjithshëm, pas këtyre veprimeve, e urdhëroi Br. XII S, që të godiste trupat pushtuese nga Saranda gjer në Topallti (krahina veriore e Vlorës). Nga fundi i korrikut deri në fillim të gushtit brigada çliroi me luftime të ashpra, Himarën dhe Borshin. Më 22 shtator në bashkëveprim me forcat e Br. XIV S, partizanët e Br. XII S shpartalluan edhe një kompani armike në Qafën e Kakomesë. Në këto luftime mbetën mjaft të vrarë, u zunë rob nga pushtuesit, si dhe u kap një material luftarak i bollshëm. Rol të rëndësishëm forcat e Br. XII S kryen në luftimet për çlirimin e qytetit të Sarandës. Këto luftime u zhvilluan në bashkëveprim me partizanët e Br. XIV S, ku armikut i shkaktuam dëme të mëdha dhe më 9 shtator 1944, çliruan përfundimisht qytetin e Sarandës. Br. XII S, mori masa të forta luftarake dhe pas një rrugëtimi nga Saranda gjer në afërsi të Vlorës, organizoi planin për çlirimin e qytetit të Vlorës. Kështu, pas një sulmi të rrufeshëm, çliroi qytetin e Vlorës më 15 tetor 1944, duke i detyruar trupat armike të iknin në panik dhe të zinin pozicione përtej lumit të Vjosës. Më 22 tetor 1944 forcat e Br. XII S çliruan ishullin e Sazanit, të pushtuar nga Italia që në dhjetor të vitit 1914, duke u bërë përgjithmonë truall i Atdheut. Në periudhën shtator-tetor 1944, Komanda e Përgjithshme e UNÇSH-së përpunoi planin operativo-strategjik për çlirimin e Tiranës. U dërguan urdhra për zhvendosjen e divizioneve, brigadave dhe njësive të tjera territoriale drejt Tiranës. Në objektiva u përcaktuan: çlirimi me çdo kusht i Tiranës dhe qyteteve të tjera rreth saj (Elbasan, Peqin, Rrogozhinë, Kavajë, Durrës, Shijak, Krujë); asgjësim ose kapje rob të forcave armike (gjermanë, kolaboracionistë) të përqendruara në trekëndëshin Elbasan-Durrës-Krujë; dëmtim të forcave gjermane pa i lënë që të tërhiqen dhe prishjen e planeve anglo-amerikane për ndonjë zbarkim të mundshëm në Durrës. Në këtë operacion të madh morën pjesë forcat e Korparmata 1 e cila përfshinte në radhët e saj: D. I, IV S; Br. I S; Br. II, XX S në drejtimin të rrugës Elbasan-Librazhd; Br. IV, V, VI; Br. VIII, X, S në drejtimin Pezë; Br. XI, XII S në drejtimin të Peqin - Kavajë dhe Br. XXIII S. Gjithsej 11 brigada për frontin e brendshëm dhe të jashtëm. Fonti i brendshëm - 2 brigada dhe më pas tre, me detyrë për të goditur Tiranën. Fonti i jashtëm - 8 brigada me detyrë dëmtim sa më shumë të armikut dhe garnizonet gjatë rrugëve të komunikacionit, çlirimin e qyteteve të zonës. Taktika e përdorur - luftë ballore me ndërthurje të taktikës guerrilase. E inkuadruar në Divizioni (D) III S në tetor 1944, Br. XII S, kaloi në Shqipërinë e Mesme, ku mori pjesë në disa operacione për asgjësimin e trupave pushtuese të cilat po largoheshin me shpejtësi në drejtim të Veriut të Shqipërisë, nëpërmjet rrugës automobilistike Elbasan - Peqin, të cilën e mbante nën goditje të vazhdueshme, për të mos lejuar armikun t'i çonte përforcime garnizonit të Tiranës. Gjatë kësaj kohe së bashku me Br. XI S mori pjesë në çlirimin e qyteteve Peqin, Kavajë e Durrës. Brigada u pozicionua në rrugën Elbasan - Peqin, ku në bashkëveprim me njësi dhe reparte të tjera të UNÇSH, i dhanë goditje kolonave pushtuese që tërhiqeshin për në veri, duke u shkaktuar humbje në njërëz, kapjen e mjaft robërve, si dhe të një materiali të bollshëm ushtarak. Nga radhët e Br. XII S dhanë jetën për Atdhe mbi 70 partizanë e kuadro, midis tyre ishin dhe Shefki Hekali, Qeriba Koka, Braho Sako, Osman Beshiri, Sinan Bllaca, Abdyl Kuka, Shefit Fetiu, Jorgo Rizo, Virtyt Dimo, Llambro Sheti, Neto Kania, Elmaz Hamiti, Labo Karma etj. Më 18 nëntor 1944 Br. XII S u rreshtua në D. I S dhe u përqendrua në qytetin e Gjirokastrës e më vonë në atë të Sarandës. Në këtë kohë kishte një efektiv rreth 1250 luftëtarë. Br. XII S është e dekoruar me medaljen e Trimërisë, për kontributin e dhënë në këtë luftë epope të bërë nga populli shqiptar, i cili me plot dinjitet u rreshtua në anën e forcave progresiste të kohës të drejtuara nga SHBA, BRSS, Britania e Madhe.



## Festohet Dita e Luleve

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit, datën 10 maj 2014, në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes, Qendra e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes organizoi një aktivitet me temë "Dita e luleve", me pjesëmarrjen e fëmijëve të ushtarakëve, që ndjekin kurset artistike pranë sektorit të Rekreacionit të QKMBM. Fillimisht fëmijët e kurseve artistike pranë QKMBM kanë performuar krijimin e kolazhit artistik floreal në sheshin qendror. Aktivitetin e ka hapur drejtori i Përgjithshëm i QKMBM, z. Jakin Marena. Në fjalën e tij, z. Marena ka theksuar se, sot është një ditë e bukur lulesh, kjo ditë nuk është vetëm një festë, por është dhe një angazhim i juaji për të mbajtur një mjedis sa më të bukur dhe sa më të pastër. "Shpresojmë që të gjithë së bashku, duke pasur ju në pararojë ta mbajmë mjedisin të pastër jo vetëm këtu, por edhe aty ku jetoni për të dhënë një shembull sa më të mirë për të gjithë fëmijët e vendit", - ka përfunduar fjalën e tij z. Jakin Marena. Në vijim të aktivitetit janë shpërndarë disa certifikata mirënjohjeje për fëmijët e kursit të pikturës. Më pas fëmijët dhe të ftuarit në këtë aktivitet kanë mbjellë lule të shumta në lulishten pranë sheshit kryesor të Ministrisë së Mbrojtjes. Në fund të aktivitetit të pranishmit kanë vizituar ekspozitën "Piktura Floreale" me punime të krijuara nga fëmijët e kursit të pikturës të QKMBM.





### Koncert me rastin e 6 majit, "Dita e Luleve"

# OFFA, pjesë e traditës në Shkodër

Data 6 maj, në Shkodër festohet si "Dita e Luleve", e cila është kthyer si traditë në këtë qytet. Përveç zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme që kishte organizuar Bashkia e këtij qyteti,mori pjesë dhe Orkestra frymore e Forcave të Armatosura. Koncerti premier i Orkestrës Frymore dedikuar "Ditës së Luleve" u drejtua nga dirigjenti i kësaj trupe n/kolonel Halim Teqja. Ky koncert i ishte përshtatur me një program artistik të shumëllojshëm duke përfshirë vepra të njohura të artistëve tanë dhe atyre të huaj. Orkestra frymore performoi me një program mbi 50 minuta në sheshin para bashkisë të qytetit të Shkodrës ku spikati loja artistike, performanca dhe serioziteti i kësaj trupe unike në Shqipëri. Publikut shkodrane me veprat e paraqitura I dhuruam disa çaste të bukura për këtë ditë të shënuar. Prezantimi i Orkestrës Frymore të Forcave të Armatosura u bë nga organizatorët si dhe u la një hapësirë për prezantimin dhe të programit për këtë ditë. Hapja e programi artistik ishin pjesët dhe marshet e njohura të Pjetër Dungut me "Garda Krutane" si dhe marshi i njohur Wien Bleib Wien nga Johan Schrammel. Pastaj program vijoi me pjesë të muzikës simfonike, big-band si dhe loja e instrumentistit Lorin Lepuri në veglën e Violinës në veprën e Morricones "Cinema Paradiso" shoqëruar nga Orkestra Frymore, ku për te cilën pati ovacione dhe përshëndetje nga publiku. Veprat e tjera ishin të një karakteri më lirik për t'ju përshtatur kësaj dite siç njihet në këtë qytet si dita e Luleve me pjesët, "Brazil-Brazil" "Rock'n Roll" si dhe në mbyllje të këtij program të veprave tashmë të njohura "Intrada" "can-can" si dhe "Sing-Sing-Sing". Pas përshëndetjeve të organizatorëve dhe të autoriteteve bashkiake, Orkestra dhe Dirigjenti i kësaj trupe mori dhe shumë urime nga artdashësit dhe publiku i këtij qyteti. Ftesa të tjera na u ofruan si në bashkëpunim me orkestrën frymore të qytetit si dhe na u la hapësirë për një koncert në sallën e Teatrit Migjeni në Shkodër. Komunikime artistike të këtij lloji presim të kemi dhe në qytete të tjera historike-turistike për te promovuar si një kujtesë të 70 vjetorit të çlirimit.




**Udhëheqës Artistik**
**Arben MUCA**

## NJOFTIM

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E MBROJTJES**
**DREJTORIA E ARSIMIMIT DHE PËRKUJDESJES SOCIALE TË USHTARAKËVE**

# Kërkim kandidaturash për pjesëmarrjen në kursin "Aspektet ligjore të mbështetjes me burime të mbrojtjes në rastet e emergjencave civile", në kuadër të programit CETPM/IMET

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Ministrisë së Mbrojtjes i është ofruar pjesëmarrja në kursin "Aspektet ligjore të mbështetjes me burime të mbrojtjes në rastet e emergjencave civile (Legal Aspects of Defense Support of Civil Authorities)", i cili do të zhvillohet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në periudhën 16.07-08.08.2014.

**Kriteret:**

| | |
|---|---|
| Niveli i gjuhës | anglisht 80 pikë; |
| Grada | e pa përcaktuar; |
| Të tjera | rekomandohet që personeli i propozuar për ndjekjen e këtij kursi të kryej detyra në shtab, planifikim, këshilltar ligjor ose detyra komanduese |

**Përshkrimi:** Ky kurs tre javor promovon mbështetjen e autoriteteve civile nëpërmjet burimeve të mbrojtjes në përputhje me parimet demokratike të rregullave dhe ligjeve në fuqi, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe përdorimi i forcës në mënyrë të arsyeshme. Kursi do të prezantojë mekanizmat ndërkombëtar ligjorë për dhënien e ndihmës humanitare në mënyrën më të mirë të pranueshme dhe në kohën e duhur, për ato vende të cilat janë goditur nga fatkeqësia natyrore.

Qëllimi i kursit është të promovojë përdorimin e burimeve të mbrojtjes me përgjegjësi dhe efikasitet, në mbështetje të forcave të policisë dhe autoriteteve të menaxhimit të emergjencave civile, si dhe të rrisë kapacitetet e vendeve partnere për planifikimin dhe marrjen e asistencës së nevojshme në rastet e një fatkeqësie natyrore, nga Shtetet e Bashkuara dhe nga vendet e tjera donatore.

Propozimet e kandidatëve të mundshëm të shoqërohen me CV-të përshkrimet e punës dhe formularët me të dhëna personale, në gjuhën angleze jo më vonë se 22.05.2014.

Për informacion dhe paqartësi, lutemi të kontaktoni pikën e kontaktit në DAPSU, Major Tahir Çuka, Tel 510 16 14, e-mail: cukat@mod.gov.al .

***Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.***

**Drejtori**
**KUJTIM KADZADEJ**

# BESË E BASHKIM







## "Urdhri Mbretëror i Shqiponjës së Zezë" dekorata e parë e shtetit shqiptar

Rreth dekoratës së Princ Vidit, studiuesi Filip Rrumbullaku, në librin e tij "Dekorimet nga Princ Vidi deri sot", i shtëpisë botuese "Onufri", Tiranë 2010, jep detaje rreth prejardhjes së kësaj dekorate të lartë.




"Njëra prej dekoratave të krijuara nga princ Vidi është edhe Urdhri Kalorësiak "Shqiponja e zezë"... një dekoratë e tillë, po me këtë emër, ekzistonte që prej dyqind vjetësh në Prusi. Ajo, ishte krijuar qysh në 17 janar të vitit 1701, nga Frederiku i Prusisë. Urdhri doli jashtë përdorimit me abdikimin e perandorit të fundit prusian në vitin 1918. Urdhri "Shqiponja e Zezë" ishte më i larti në Prusi dhe jepej nga perandori për merita të shquara civile e ushtarake dhe u akordohej anëtarëve të shtëpive mbretërore, zyrtarëve më të lartë civilë e ushtarakë dhe figurave të tjera emëruar prej tij. Princ Vidi e njihte këtë dekoratë dhe mund të hamendësojmë se emri i saj duhet të jetë shfrytëzuar për të krijuar dekoratën e parë të shtetit të ri shqiptar. Urdhri shqiptar "Shqiponja e zezë" përbëhet nga pesë klasë: "Kryqi i madh", "Oficeri i madh", "Komandanti", "Oficeri", dhe "Kalorësi", klasifikime këto të njohura për të gjithë urdhrat kalorësiakë. Po me këtë emër "Shqiponja e zezë", u krijua edhe një medalje me tri shkallë. Sasia e pakët e prodhimit sidomos për shkallët e larta, dhe përdorimi deri diku i kufizuar edhe për shkallët e tjera, për shkak të kohës së shkurtër të mbretërimit të princ Vidit, e bën sot këtë urdhër mjaft të rrallë. Ndërsa medalja mund të gjendet në mjaft familje shqiptare, me gjithë traditën e pakët të ruajtjes në arkiva personalë e për shkak të persekutimit të familjeve të mëdha apo të mesme gjatë mesit të shekullit XX"- thotë Filip Rrumbullaku në librin e tij.